

PASHKË 2020

Pa frikë

† *Anastasi*

Kryepiskop i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë

*Klerit dhe popullit
shpresëtar e Orthodhoks,*

*Bij fort të shtrenjtë më
Zotin,*

*“Mos kini frikë”
(Matth.28:10)*

Një nga dhuratat kryesore që na fali Zoti i Ngjallur, theksohet në himnin e periudhës pas-kale: “Kur ishin dyert mbyllur, Jisui iu shfaq nxënësve, **u largoi frikën dhe u dha paqen**”. Me fuqinë që na jep kjo lloj mospasjeje frikë, nxënësit që më parë ishin rrëzuar prej “*frikës së judenjve*”, u treguan “*në të gjitha kombet*” apostuj të patrembur, dëshmitarë të Ngjalljes së Tij.

Frika është një këshilluese e keqe e njeriut. Ajo depërton me mënyra të ndryshme në mendimin dhe në vullnetin tonë, duke na ulur rezistencën dhe kreativitetin. Të njeriu frikën e shkaktajnë shkaqe të ndryshme: konfliktet e armatosura, katastrofat natyrore, sëmundjet epidemike, si pandemia e tanishme e COVID-19, që ka tronditur mbarë njerëzimin. Në nivelin personal frikë shkaktajnë armiqësitë, padrejtësitë, konfliktet e ndryshme individuale, por shpesh edhe dobësitë tona. Frika njerëzore kulmon veçanërisht kur njeriu ndodhet para vdekjes.

“Mos kini frikë” (Matth. 28:10) u tha Krishti i Ngjallur grave miroprrurëse; “*Paqe mbi ju*” i përshëndeti Ai nxënësit e Tij dhe



shtoi: “*Merrni Shpirt të Shenjtë*” (Jn. 20:22). Jeta juaj do të mbështetet në fuqinë dhe në veprimin e vazhdueshëm të Shpirtit të Shenjtë brenda qenies suaj. Që nga ajo kohë, Shpirti i Shenjtë i fuqizon të gjithë nxënësit e Tij, duke e lidhur të mospasurit frikë me paqen dhe dashurinë. Dhe për më tepër, Zoti i siguroi se do të jetë bashkë me ta, gjithë ditët “*deri në mbarim të jetës*” (Matth. 28:20).

*

Ekziston një lidhje organike midis të mospasurit frikë, që na e dhuron Krishti, dhe frikës së Perëndisë, që është “*fillimi i diturisë*” (Fjalët e Urta 9:10) dhe që do të thotë përgjërë, shpresëtar, ndërjegjësim për praninë e Tij. Kjo frikë Perëndie është burimi jetësor, që fuqizon mospasjen frikë. Ai që ka frikë Perëndinë, nuk frikësohet nga askush dhe nga asgjë. Kjo mospasje frikë, së cilës i referohemi nuk ka asnjë lidhje me optimizmin

abstrakt, por mbështetet te besimi në Perëndinë dhe në dashurinë e shprehur me vepra.

Ndjesia e pranisë së vazhdueshme të Perëndisë e dëbon frikën përgjatë ecurisë sonë të përditshme: “*Sepse edhe po të eci në mes të hijes së vdekjes, nuk do të kem frikë të këqijat, sepse ti me mua je*” (Ps. 22:3), na siguron psalmisti. Dhe një poet i brezit tonë plotëson: “Kur je krah meje dehëm nga lavdia Jote. As edhe veten time nuk e kam më frikë”.

Sot, mendimi dhe sjellja jonë janë robëruar nga koronavirusi. Por, ne nuk duhet ta lejojmë këtë armik të padukshëm të na gjunjëzojë. Teksa qëndrojmë në shtëpi, nuk duhet të izolohehi, përkundrazi, le ta mbështesim njëritjetrin, me fjalë dhe veprime të thjeshta, me heshtje të dhembshur, me dëshirë të mirë dhe gëzim. Për më tepër nuk duhet të kufizohemi duke mbështetur vetëm familjen tonë; le ta zgjerojmë interesimin tonë edhe te miqtë, tek ata që ndodhen afër dhe larg. Është nevojë urgjente që të marrim pjesë në betejën për çlirim nga sindroma e frikës, e cila po përhapet rreth nesh në mënyrë të pakontrolluar. Nuk do të na braktisë Perëndia! Diçka e mirë do të dalë edhe nga kjo sprovë e madhe. Kjo luftë, e paparë ndonjëherë, do të fitohet me anë të mobilizimit të përgjithshëm, mbarënjëzor të solidaritetit.

(vijon në faqen 2)

(vijon nga faqja 1)

Të mospasurit frikë, që na fal Krishti, kulmon para vdekjes. Kjo frymëzohet nga bindja se: “Edhe nëse rrojmë pra, edhe nëse vdesim, të Zotit jemi” (Rom. 14:8). “Askush le të mos e ketë frikë vdekjen” na mëson shën Joan Gojarti, “sepse prej saj na çliroi vdekja e Shpëtimtarit”. Gjithë krentimi i Pashkës shtjellon dhe fuqizon këtë përvojë themeltare të Kishës sonë. Siguria për kapërcimin e vdekjes na ofron një perspektivë të ndryshme në jetën e përditshme: “Ne e dimë se kemi shkuar prej vdekjes në jetë, dhe këtë e dimë, sepse i duam vëllezërit” (1Jn. 3:14). Kjo është eksperiencia ndër shekuj e njerëzve të panumërt, që jetojnë besimin dhe dashurinë më Krishtin. “Frikë nuk ka në dashuri, por dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën” (1Jn. 4:18).

Pashkë të mbarë, vëllezërit e mi! Me Ngjalljen brenda nesh! Le të bëhet zemra jonë “tempull i Perëndisë së gjallë” (2Kor. 6:16). Befasisë dhe shqetësimit që shkaktoi kjo pandemi e dhimbshme, le t’i kundërvëmë të mospasurit frikë që na fal Krishti i Kryqëzuar dhe i Ngjallur. Një mospasje frikë plot me paqe dhe solidaritet.

Sivjet nuk do të mund ta transmetojmë dritën e Ngjalljes, nga njëra llambadhe te tjetra. Le të transmetojmë dritën e shpresës dhe të mospasjes frikë që na fal Krishti nga njëra zemër te tjetra! Krishti u Ngjall!

Me dashuri të tërëshpirtshme në Krishtin Jisu, Shpëtimtarin tonë,

† **Anastasi**

Kryepiskop i Tiranës, Durrësit
dhe i Gjithë Shqipërisë



E Diela e Orthodhoksisë (8 mars)

E Diela e Orthodhoksisë, më 8 mars 2020, ishte Liturgjia Hyjnore e fundit që besimtarët orthodhoksë e krenatuan me madhështinë e periudhës së Pashkës. Shpresojmë që shumë shpejt, ata do të marrin pjesë përsëri në Shërbesat e bukura Orthodhokse, në kishat e tyre.



Pashka ndryshe 2020 në Kishën tonë

Shërbesat dhe Liturgjia Hyjnore Ngjallësore u kryen me kujdes, duke respektuar rregullat e mbrojtjes nga COVID-19, ndërsa besimtarët iu drejtuan kishave në mbarë vendin

Në kushtet e rregullave të vendosura nga shteti, mbi bazën e rekomandimeve të OBSH-së, për përballimin e gjendjes së jashtëzakonshme për shkak të pandemisë nga Covid-19, Kisha jonë përshtati programin e shërbesave dhe kremtimit e Ngjalljes. Shërbesat e shenjtja u zhvilluan pa praninë e besimtarëve të shumtë, siç ndodh çdo vit dhe pa litanitë emocionuese të Epitafit në të Premten e Madhe apo panaiet popullore të Javës Paskale. E



megjithatë, duke kryer gjithçka që parashikon Tipikoja, u bë e mundur që Kisha jonë t'u ofronte besimtarëve edhe një herë tjetër shërbesat dhe misteret e periudhës më qendrore të vitit shpirtëror. Natyrisht, pika kulmore ishte Liturgjia Hyjnore Ngjallësore, së cilës i parapriu Shërbesa e Ngjalljes në Kishën Katedrale të Ngjalljes së Krishtit në Tiranë, ku celebroi Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Anastasi, në bashkëmëshim me Mitropolitin e Amantias, Nathanailin, Episkopin e Bylisit, Astin, si

dhe klerikët e Kryepiskopatës së Hirshme të Tiranës. Me gjithë vështirësitë, dhjetëra besimtarë patën mundësinë që të merrnin pjesë në adhurim dhe të kungoheshin me Misteret e Shenjta në përfundim të Liturgjisë Paskale. Në kisha ishin marrë të gjitha masat për ata besimtarë që ishin të pranishëm në shërbesa, duke zbatuar me rigorozitet rregullat e mbrojtjes nga virusi.

Kryesisht gjatë Javës së Madhe, në të gjitha kishat e zonës episkopale të Kryepiskopatës u tregua kujdes për shmangien e grumbullimeve të besimtarëve. Respektivisht, kambanat vajtuese të së Enjtes së Madhe pasdite dhe të së Premtes së Madhe, por sidomos kambanat ngjallësore në mesnatën e së Shtunës për të Dielën e Pashkës, kumbuan në dhjetëra enori dhe veçanërisht në katedralet e Mitropolive të tjera të Kishës sonë: në Berat, Korçë, Gjirokastër, Fier, Elbasan. Nën kujdesin e mitropolitëve lokalë, në shumë kisha, ku pati prift apo në fshatrat ngjitur, ku ata mund të lëviznin, u kryen gjithashtu shërbesat e Javës së Madhe dhe ajo e Ngjalljes. Si në Kishën Katedrale në Tiranë edhe në qendrat e Mitropolive u lexua Mesazhi Paskal i Kryepiskopit Anastas. Ai përputhej veçanërisht me situatën, me idenë bazë të Mospasjes Frikë, që Zoti ynë Jisu Krisht u frymëzon Nxënësve të Tij, por diakronikisht edhe gjithë të Krishterëve, dhe që këtë vit, si asnjëherë tjetër, grigja e Kishës në Shqipëri ka aq shumë nevojë për mesazhe të tilla.



Kryepiskopi, gjatë tri dekadave në krye të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, këtë ide të të mospasurit frikë, nuk e ka predikuar teorikisht dhe as që të kuptohej dhe interpretohej në mënyrë abstrakte. Përkundrazi, në momente decizive, ka dëshmuar me shembullin e tij mbështetjen e vendosur në besimin e thellë dhe shpresën në Jisu Krishtin e Ngjallur. Vetë ndërmarrja e "peripicisë" së ringritjes së Kishës në Shqipëri, është akt mospasjeje frikë, akt burërie, besimi të thellë dhe dashurie të përsosur, që e mposht frikën dhe ngurrimin. I një rëndësie të posaçme është fakti se Kryepiskopi Anastas u soll me urtësi sapo u shpallën masat e jashtëzakonshme për përballimin e pandemisë, veçanërisht gjatë kremtimeve të periudhës së Pashkës. Konkretisht vetë ai ishte në krye të fushatës së informimit dhe sensibilizimit të grigjës për këto masa, por duke theksuar jo vetëm kujdesin që duhej treguar, por veçanërisht edhe për ndihmën e solidaritetin për njerëzit përreth. Gjithashtu, u caktua një kuadër i

qartë i asaj se çfarë do vazhdonte dhe çfarë do të pezullohej përkohësisht në jetën adhuruese e shpirtërore. Kështu, ndërsa programi i shërbesave u kufizua dhe numri i pjesëmarrësve në to u kufizua nën kujdesin e priftërinjve dhe këshillave kishtarë, por nuk u pezulluan krejtësisht. Liturgjia Hyjnore Ngjallësore në Kishën Katedrale të Tiranës u transmetua, siç është traditë, nga Televizioni Publik Shqiptar, por, në përputhje me gjendjen, për t'u shkuar pranë besimtarëve që qëndronin në shtëpi, u transmetuan të plota edhe shërbesat e së Enjtes së Madhe, të së Premtes së Madhe dhe Mbrëmësorja e Dashurisë në të Dielën e Pashkës. Një pasqyrim të gjerë, këto shërbesa patën edhe në kanalet televizive private. Meqenëse autoritetet shtetërore, përfaqësuesit e forcave politike etj., nuk mundën të uronin, sipas traditës, në selinë e Sinodit të Shenjtë, urimet për Kryepiskopin, grigjën dhe klerin Orthodhoks i shprehën nëpërmjet mjeteve të informimit.

Urime për Pashkë nga autoritetet e larta shtetërore dhe politikanë

Me rastin e Pashkës, Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe gjithë besimtarët orthodhoksë i kanë uruar edhe personalitete politike.



Presidenti, Z. Ilir Meta:

Të dashur qytetarë shqiptarë!
Të dashur besimtarë ortodoksë!

Pashkë të mbara e të bardha për të gjithë! Gëzuar për shumë vjet, shëndet të plotë, mirësi e begati në çdo familje!

Sivjet, një armik i padukshëm, që po kushtëzon mendimet dhe sjelljet tona të përditshme, na detyron mos ta kremtojmë siç do donim këtë Festë të Madhe e të Shenjtë. As Dritën e Ngjalljes nuk do mundemi dot ta marrim sot në Kishë dhe ta kalojmë nga dora në dorë, për ta çuar në shtëpitë tona.

Por Krishti i Ngjallur na mëson: **MOS KINI FRIKË!** Nxënësit e Tij të vërtetë, duhet të bëhen “dritë e botës”. Kështu le të shndrisë drita juaj përpara njerëzve, që të shikojnë veprat tuaja të mira dhe të lavdërojnë Atin tuaj në qiej.

Me kurajën dhe shpresën që na fal Krishti i Ngjallur dhe me Ngjalljen brenda nesh, le ta përjetojmë këtë Ditë të Bekuar dhe mesazhin e saj në thellësitë e zemrës dhe shpirtit tonë, dhe ta përhapim atë jo vetëm brenda familjeve tona, por edhe tek të

afërmit e miqtë tanë që ndodhen fizikisht larg nesh, tek të moshuarit, të sëmurët, të vetmuarit dhe njerëzit më në nevojë.

Le të falim sot më shumë solidaritet mbarëkombëtar dhe paqe, me fjalë e vepra të thjeshta dashurie, le të ndajmë sot të mirat dhe gëzimet tona, për të ndriçuar honet e errëta të ndasive, zbrazëtisë së brendshme, vetmisë dhe varfërisë, veçanërisht të atyre që vuajnë nga mjerimi, dhimbjet dhe braktisja.

Le të shpërndajmë sot Dritën e Ngjalljes tek të gjithë, për të mbështetur njëri-tjetrin në betejën e përgjithshme për t’u çliruar nga frika dhe pandemia dhe për t’u bashkuar me njëri-tjetrin në një përpje-kje të re në të mirë të lirisë së shpirtit, drejtësisë, të vërtetës, begatisë, mirëkuptimit, pajtimit, vëllazërimit dhe dinjitetit tonë njerëzor.

Le të lutemi sot edhe për heronjtë e ditëve tona, mjekët dhe infermierët, e për këdo që është në vijën e parë të mbrojtjes së shëndetit dhe të sigurisë së çdo qytetari. Por edhe për priftërinjtë e klerikët që në krye të misionit të tyre hyjnor e fisnik po bëjnë aq shumë për ne të gjithë në këto momente tepër të vështira, veçanërisht për komunitetet më të përvuajtura.

Një urim të veçantë kam sot për komunitetin e dashur të shqiptarëve në Greqi dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës të prekura rëndë nga pandemia, dhe për të gjithë bashkadhëtarët tanë kudo në botë.

Uroj të kremtojmë Pashkën me frymë, energji dhe shpresa të ripërtërira, me ngjallje të vërtetë në

shpirtrat e zemrat tona, për një shoqëri solidariteti dhe përgjegjësie të përbashkët.

Kryetari i Kuvendit, Z. Gramoz Ruçi:

“Me rastin e Festës së Pashkëve, uroj të gjithë besimtarët ortodoksë, si edhe të gjithë shqiptarët: Shëndet dhe lumturi në vatrën tuaj familjare! Këto Pashkë na gjejnë fizikisht të izoluar, por më shumë të bashkuar prej mesazhit thelbësor të kësaj Feste, shpresës së ringjalljes e ringritjes. Përhëndes në mënyrë të veçantë ata që Festa e Pashkëve i gjen duke luftuar në betejën për jetën, në vështirësi apo larg vatrave familjare.

Sot, të gjithë e kemi kuptuar se sa e mrekullueshme është jeta dhe paqja dhe sa pa kuptim janë marramendja pas urrejtjes e konflikteve.

Qëndresa stoike dhe beteja që po zhvillojmë për mbrojtjen e jetës, na ka bindur se askush nuk shpëton duke qenë i vetëm, por në bashkëveprim, mbështetje e solidaritet me të gjithë.

Përditë e më shumë po bindemi se njerëzimi, pavarësisht kombeve, shteteve, pa-surisë, varfërisë dhe ndarjeve që shkaktojnë ato, është një familje e madhe 7.7-miliardëshe, që u përgjigjet si një e vetme rrezikimit të jetëve njerëzore nga pandemia COVID-19.

Sot është dita t’u rikthehemi edhe njëherë mësimëve të krijesve, arkitektëve dhe ndërtuesve të qytetërimit dhe t’i zbatojmë ato jo vetëm në betejën për jetën, por në të gjithë veprimtarinë tonë.

**KRISHTI U NGJALL!
VËRTET U NGJALL!**



Përditë e më shumë po bindemi se nga pandemia nuk na mbrojnë vetëm vaksinat e kurat mjekësore, por edhe antitruapat e dashurisë, drejtësisë e solidaritetit njerëzor, vlera që këto kohë po shkëlqejnë në të gjithë planetin, si eliksiri më i dobishëm kundër së keqes që kërcënon njerëzimin.

Prandaj, me kurën e dashurisë, humanizmit e solidaritetit të luftojmë edhe sëmundjet e shoqërisë: varfërinë, pabarazinë, ndarjet e konfliktet, në çdo formë që ato shfaqen.

Festa e Pashkëve të na frymëzojë që të punojmë më shumë për të ndalur globalizimin e së keqes, përhapjen e formave të ndryshme të dhunës, të indiferencës njerëzore ndaj njëri-tjetrit, të të dobëtëve, të sëmurëve, të pambrojturve, ndaj natyrës dhe mjedisit.

Krahas globalizimit të mallrave, shërbimeve, teknologjive dhe ideve, të investohemi për të globalizuar solidaritetin dhe përkushtimin njerëzor.



Kryeministri, Z. Edi Rama:

Kryeministri, Z. Edi Rama, uroi përmes Facebook-ut, ku shkruan: “Në këtë kohë të çuditshme tempujsh të kyçur, vij-në edhe Pashkët Ortodokse, pa kishat hapur, por me Zotin pranë çdo familjeje që sonte feston.

GËZUAR PASHKËT!”

Kryetari i Partisë Demokratike, Z. Lulzim Basha:

“Me urimin tradicional “Krishti u ngjall!” dhe këtë foto të lepurshëve të Pashkëve të përgatitur nga vajzat e mia, u urojmë familjarisht të gjithë besimtarëve ortodoksë, nga mot Gëzuar!

Sot, urimet dhe lutjet tona të para, janë për të gjithë anëtarët e familjes sonë të madhe, që përballen me virusin dhe pasojat e tij, për mjekët dhe infermierët tanë kurajozë e të palodhur, për të gjithë ata që shërbejnë me sakrificë të mëdha për të na mbrojtur dhe ndihmuar, për të gjithë shqiptarët në nevojë dhe shtrëngesë, për shërbëtorët e Zotit që me lutjet e



tyre, sjellin paqe e shpresë në shpirtin e çdokujt. Zoti ju bekoftë ju dhe familjet e të dashurit tuaj! Zoti e bekoftë Shqipërinë!”

Kryetarja e LSI, Znj. Monika Kryemadhi

“Festa e shenjtë e Pashkëve na mëson se sakrificë nuk është humbje dhe se ndriçimi i zemrës përmes besimit na lartëson mbi të keqen dhe antivlerat. Fuqia e shpirtit i jep njeriut forcën për të çarë mes vështirësive dhe për të ndërtuar të ardhmen.

Masat e distancimit fizik prej pandemisë nuk duhet të na ndajnë shpirtërisht nga njëri-tjetri dhe nga zakonet tona të mira. Përmes tyre, ne si komb kemi përballuar ndër

shekuj vështirësi pas vë-shtirësive, dhe sot është koha që, ashtu siç kemi gjetur mënyra të reja për të kremtuar festat tona fetare, ashtu të hapim rrugën për të ndërtuar të ardhmen tonë të përbashkët. Me besimin në Zot, me dashurinë për njëri-tjetrin, me vlerat dhe traditat tona kombëtare.

Pashkë të mbara për të gjithë besimtarët ortodoksë dhe gjithë familjet shqiptare! Krishti u ngjall!”

Ambasada Amerikane

“Nga komuniteti ynë në komunitetet dhe familjet tuaja, i urojmë Gëzuar Pashkët të gjithë bashkësisë ortodokse në Shqi-

përi! Sjellte kjo ditë e shenjtë gëzim, paqe dhe shpresë në të gjitha familjet tuaja!”

Ish-Presidenti, Z. Sali Berisha:

Te dashur miq, sot besimtarët ortodoksë shqiptarë festojnë Pashkën, ditën e Ngjalljes së Krishtit Mbret, Burrit, Hyjit të përjetshëm që, me parimet, mësimet e tij, formësoi qytetërimin perëndimor. Kjo ditë e bekuar frymëzon për të gjithë

besimtarët e Zotit shpresë, besim dhe paqe.

Ndaj dhe ne le t’u urojmë atyre nga zemra Gëzuar Pashkën dhe të lutemi bashkërisht që, Pashka që vjen, mirë se të na gjejë! Gëzuar!!

Pako ushqimore dashurie “Pashkë 2020”

Me rastin e Pashkës, stafi i Zyrës së Rinisë Orthodhokse, të Kryepiskopatës, me mbështetjen e mjaft miqve dashamirës nga brenda dhe jashtë vendit, organizoi dhe përfundoi në një kohë mjaft të shkurtër, deri të Mërkurën e Madhe, në datën 15 prill 2020, nismën e radhës. Të rinjtë mblodhën ndihma për 70 familje në nevojë, në Tiranë dhe Gramsh, të cilat, në situatën e rënduar ekonomike dhe të përkeqësuar prej pandemisë, kanë nevojë edhe për ushqimet bazë.

Besimtarë dhe miq ofruan ushqime të shportës (miell, oriz, fasule, vaj, sheqer, makarona, konserva, ëmbëlsira etj.), si dhe vlera monetare, të cilat u përdorën për kompletimin, sipas parashikimit të përmbajtjes së pakos.

Familjet në nevojë të identifikuar, pa asnjë dallim fetar, ishin me anëtarë të moshuar, të sëmurë, të vetmuar apo me shumë fëmijë. Gjatë shpërndarjes, për të shmangur grumbullimin e



njerëzve dhe për të zbatuar distancimin fizik, u zbatuan me përpikmëri të gjitha masat e autoriteteve të shëndetësisë, ku një pjesë e ndihmave u dorëzua derë më derë dhe pjesa tjetër në mjedise të hapura, pranë banesave të tyre apo në oborret e kishave. Nisma të tilla janë organizuar nga Kisha jonë në çdo Mitropoli.

Ato janë tregues dashurie, për të cilën shoqëria e sotme shqiptare ka aq shumë nevojë, si për ata që i përfitojnë, edhe për ata që i dhurojnë.

Është detyrë dhe kënaqësi shpirtërore e çdo të krishteri të ofrojë dhe mbështesë këdo që ndodhet në vështirësi, jo vetëm në kohë pandemie, sepse “Mbani barrët e njëri-tjetrit dhe kështu do të përmbushni, ligjin e Krishtit”. (Galatianëve 6:2)

Jani Meni,

Koordinator i Zyrës së Rinisë Orthodhokse, Tiranë.

REZISTENCË NDAJ PANDEMISË

† Anastasi
Kryepiskop i Tiranës,
Durrësit
dhe i Gjithë Shqipërisë

Vëllezër dhe motra,

Në këtë kohë, të gjithë jemi zënë në befasi, njësoj sikur të jetë shpallur një Luftë e re Botërore nga një armik i padukshëm.

Të gjithë ndihemi të pavenosur para ndryshimeve të paparashikueshme, që kjo pandemi (COVID-19), e paparë ndonjëherë, ka sjellë në jetën e të pasurve dhe të varfërve, të njerëzve të shkolluar e të thjeshtë, në shëndetin e tyre, në ekonomi, në lëvizjen e njerëzve, në format e argëtimit, në mënyrën se si festojmë.

Është detyra jonë që të shmangim panikun, depresionin dhe dëshpërimin. Nga ne kërkohet gjakftohtësi, kthjelltësi, vëmendje dhe bindje e shtuar ndaj udhëzimeve të Qeverisë dhe të strukturave të shëndetësisë. Duhet të

falënderojmë përzemërsisht të gjithë ata që përkujdesen për higjienën, rendin publik, informimin dhe, mbi të gjitha, mjekët e infermierët, të cilët ndodhen në vijën e

mirëkuptimit, dhembshurinë dhe dashurinë.

Sa jemi besimtarë, le ta intensifikojmë lutjen tonë, që kjo periudhë sprove të mos zgjatë më



parë të luftës për shërimin e të sëmurëve.

Duke qëndruar brenda në shtëpi, të mos lejojmë që të na pushtojë nervozizmi dhe grindjet, por të kultivojmë kreativitetin, predispozitën paqësore, mirësinë,

tejt, që të shërohen të sëmurët rëndë e të ndalet përhapja e mëtejshme e pandemisë (COVID-19). Dhe, për më tepër, që Perëndia të ndriçojë grupet e shkencëtarëve dhe të gjendet sa më shpejt trajtimi parandalues dhe shërues ndaj këtij virusi.

Mbi të gjitha, kemi nevojë urgjente që të forcojmë besimin tonë te Perëndia. Besimi dhe dashuria janë armët më të fuqishme mbrojtëse edhe ndaj sulmit të këtij virusi të padukshëm që po kërcënon njerëzimin. Në fund fare, diçka e mirë ka për të dalë edhe nga kjo krizë dhe shpresojmë që shoqëria njerëzore t'i rishikojë vlerat dhe përparësitë e saj.

Pra, vëllezër e motra, le t'i themi Jo tronditjes dhe shqetësimit! Le të kemi më tepër guxim e fuqi për ta përballuar me dinjitet këtë sprovë, le të tregojmë më shumë bindje ndaj udhëzimeve e mbi të gjitha, le të kemi solidaritet të sinqertë. Paqja dhe shpresa e Perëndisë le të fuqizojnë durimin dhe rezistencën tonë dhe le t'i drejtojnë vendimet që duhet të marrim në zgjedhjet dhe ndryshimet që tashmë janë bërë të detyrueshme në jetën tonë.

20 mars 2020

“Le të transmetojmë dritën e shpresës nga njëra zemër në tjetrën”

Intervistë e Kryepiskopit të Shqipërisë, ish – President i WCC (Këshillit Botëror të Kishave)

(është përkthyer në 7 gjuhë dhe qarkulloi në internet në të gjitha kontinentet)

Nga Marianne Ejdersten, Drejtoreshë e Komunikimeve e WCC

Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit dhe i Gjithë Shqipërisë, Anastasi, në këtë intervistë, ndan me ne vizionin e tij rreth mënyrës se si po përshtaten Kishat në Shqipëri dhe në mbarë botën, me pandeminë e COVID-19. Ndërsa lutemi që shkencëtarët të gjejnë një mjekim për ta luftuar këtë pandemi, kishat duhet të theksojnë detyrimin tonë për të qëndruar në shtëpi, si dhe për ta çliruar veten nga frika e ankthi. Duhet të gjejmë mëny-

rat se si t'u gjendemi pranë të sëmurëve direkt ose indirekt, tani që jemi në periudhën e përgatitjes së Pashkës dhe t'ia hapim zemrat tona dritës së paqes.

Fortlumtura Juaj, si duhet ta përshtatin Kishat jetën e tyre në mes të shpërthimit të koronavirusit?

Kryepiskopi Anastas: Kur u informuam për përhapjen e pandemisë së COVID-19 në Shqipëri, iu drejtuam popullit tonë (më 12 mars dhe më 17 mars 2020), duke insistuar në shmangien e panikut, depresionit dhe

dëshpërimit. Theksuam se në një situatë të tillë na kërkohet vetëpërmbytje, përkorje, vigjilencë dhe bindje e shtuar ndaj udhëzimeve dhe direktivave shëndetësore të qeverive të përgjegjshme. Njoftuam besimtarët tanë se anuluar të gjitha shërbesat në Kishat tona dhe i këshilluam t'u shmangeshin përqaftimeve tradicionale, puthjes së objekteve të shenjta në kishë, puthjes së duarve të klerikëve dhe çdo lloj kontakti fizik. Çdo të Diel dhe të Kremte të Madhe, ne celebruam, me dymbyllura, Liturgjinë Hyjnore në Kishëzën e Qendrës Sinodike. Këto shërbesa transmetohen nga Radio “Ngjallja” e Kishës sonë si

dhe mund të ndiqen online. Edhe në Dioqezat e tjera të vendit, shërbesat kishtarë do të vazhdojnë të kryhen me dyer të mbyllura në kisha të vogla. Këshilluam personat më të rrezikuar ndaj kësaj pandemie, të moshuarit si dhe fëmijët, që të qëndrojnë në shtëpi për një periudhë të caktuar kohore. Kishat do të vazhdojnë të mbeten të hapura gjatë ditës për lutje personale. Besimi dhe dashuria janë armët më të fuqishme mbrojtëse kundër sulmeve të këtij virusi të padukshëm. Jam në dijeni se edhe Kisha të tjera i kanë këshilluar besimtarët e tyre të veprojnë në mënyra të ngjashme.

Si mund të jenë Kishat në Shqipëri model për të tjerët?

Kryepiskopi Anastas: Ne morëm disa nisma, duke i bashkëndarë idetë tona me komunitetet e tjera fetare në Shqipëri. Por është e tepërt të themi se ne jemi “model” për të tjerët. Çdo Kishë, në vende të ndryshme, duhet t’u përgjigjet nevojave dhe situatave specifike. Më 20 mars, ne iu drejtuam shoqërisë multifetare në Shqipëri me një mesazh më të përgjithshëm, i cili u botua dhe u transmetua nga masmedia e vendit. Në këtë mesazh, midis të tjerave, falënderuam përzemësisht të gjithë ata që përkujdesen për higjienën, rendin publik, informimin dhe, mbi të gjitha, mjekët e infermierët, të cilët ndodhen në vijën e parë të luftës për shërimin e të sëmurëve. Në mesazhin tonë theksuam domosdoshmërinë se, ndërsa jemi brenda në shtëpi, të mos lejojmë që të na pushtojë nervozizmi dhe grindjet, por le të kultivojmë kreativitetin, predispozitën paqësore, mirësinë, mirëkuptimin, dhembshurinë dhe dashurinë.

Theksuam, gjithashtu, se të gjithë ne besimtarët duhet të intensifikojmë lutjen, që kjo periudhë sprovë të mos zgjatë më tej, që të shërohen të sëmurët e të ndalet përhapja e mëtejshme e pandemisë (COVID-19). Dhe, për më tepër, që Perëndia të ndriçojë grupet e shkencëtarëve dhe të gjendet sa më shpejt trajtimi parandalues dhe shërues ndaj këtij virusi. Në fund fare, diçka e mirë ka për të dalë edhe nga kjo krizë dhe shpresojmë që shoqëria njerëzore t’i rishikojë vlerat dhe përparësitë e saj.

Si mund ta mbrojmë jetën? Çfarë mund të bëjmë ne, si Kisha dhe komunitete fetare?

Kryepiskopi Anastas: Së pari, duhet të theksojmë detyrimin që kemi për të qëndruar në shtëpi sipas udhëzimeve të qeverisë dhe të strukturave shëndetësore. Duhet të ndalojmë udhëtimet dhe qarkullimin e njerëzve. Le të jemi vigjilentë që këto masa të mos na çojnë në izolim personal. Përkundrazi, le t’i ofrojmë mbështetje njëri-tjetrit me kurajë, lutje, fjalë, veprime të thjeshta, me heshtje të mbushur plot me dashuri; veçanërisht atyre që janë në rrezik më të madh.

Është e rëndësishme që në ndërgjegjen e komunitetit të ekzistojë vetëdija se shërbesat po kryhen vazhdimisht në kishëzat e të gjitha Dioqezave me dyer të mbyllura- si qirinj

një numër i madh i personave të riskuar nuk kanë mundësi t’i ndjekin shërbesat?

Kryepiskopi Anastas: Atje ku Kisha e ka mundësinë për të ofruar transmetime të shërbesave në televizion ose në radio, ne mund t’i përmirësojmë më tej këto forma, duke i këshilluar njerëzit tanë që t’i ndjekin këto transmetime. Sa i takon Shkollës të së Dieles, për fëmijët, mund të jepen mësimet dhe video online dhe të ndahen nga enoritë e ndryshme. Besimtarët mund të krijojnë edhe një shtëpi-kishë për këtë periudhë, duke i kryer shërbesat në grupin e vogël të familjes, ndoshta edhe me një familje fqinjë, që të luten së bashku. Një tjetër propozim është krijimi i grupeve të studimit të Biblës. Mundësi të tjera janë edhe këndimi e dëgjimi së bashku i muzikës dhe i himneve të Kishës.

World Council of Churches

A worldwide fellowship of churches seeking unity, a common witness and Christian service

English Deutsch Français
Español ...

Search Site

About us Member churches What we do Get involved Resources Press centre

News

Archbishop
Anastasios: "Let us
transmit from heart to
heart the light of
hope"

You are here: Home / Press centre / News / Archbishop Anastasios: "Let us transmit from heart to heart the light of hope"

Archbishop Anastasios: "Let us transmit from heart to heart the light of hope"

28 March 2020

Interview with the Archbishop of Albania, former President of the WCC

by Marianne Ejdersten, WCC director of Communication

Archbishop Anastasios of Tirana, Durrës and All Albania shares his perspective in this E-interview about the way churches are adapting, both in Albania and worldwide, to the COVID-19 pandemic. As we pray for the researchers trying to find a treatment, churches can also emphasize our duty to stay at home while, at the same time, freeing ourselves from fear and anxiety. We must find ways to assist the sick directly or indirectly, as we prepare for Easter, and open our hearts to the light of hope.



Photo: Xanthi Morfi/WCC

simbolikë. Nuk është vetëm koronavirusi që transmetohet, por në këtë kohë duhet të transmetojmë lirinë nga frika dhe ankthi, të bazuar në besim dhe vazhdimisht duhet të ofrohet dashuri me një predispozitë të gëzuar.

Çfarë mund të bëjmë kur mbledhjet e sigurta nuk janë më të mundshme ose kur

Po në lidhje me stigmatizimin dhe diskriminimin?

Kryepiskopi Anastas: Do të ishte gabim i madh diskriminimi ose vendosja e një stigme mbi ata që janë infektuar nga kjo sëmundje. Përkundrazi, kjo peripeci i fut ata në kategorinë

(vijon në faqen 8)

(vijon nga faqja 7)

“e më të vegjëlve”, që Krishti i përmend në fjalën e Tij në lidhje me Gjykimin e Fundit (Matheu 25). Qëndrimi ynë ndaj këtyre rasteve të reja “të më të vegjëlve” është qëndrim ndaj vetë Krishtit. Ne duhet të gjejmë mënyra për të ndihmuar të sëmurët, direkt ose indirekt, të ndihmojmë familjet dhe fëmijët e tyre në kushtet e mbijetesës. Sigurisht, ne jemi të detyruar të mbështesim të gjithë specialistët e kujdesit shëndetësor, të cilët janë në kontakt të përditshëm me virusin dhe t’u shprehim atyre mirënjohjen tonë të vazhdueshme nëpërmjet lutjes dhe duke ndjekur udhëzimet e tyre.

Ndërsa Shqipëria po përballlet me sfida të paprecedenta, sipas mendimit tuaj, si mund të lutet shoqëria globale?

Kryepiskopi Anastas: Lutja e përbashkët për të gjitha vendet është që ta kalojmë këtë sprovë me sa më pak viktima. Pandemia krijon jo vetëm sëmundje, por edhe pasoja të rënda ekonomike, madje shkatërrimtare për vende të varfra si Shqipëria, e cila ka vuajtur kohët e fundit edhe pasojat shkatërrimtare të një tërmeti të madh. Pandemia nuk është lokale, është globale. Prandaj, përgjigjja ndaj saj duhet shoqëruar nga një solidaritet global për të pasur në këtë rast “globalizimin e solidaritetit”. Vendet e pasura kanë përgjegjësinë që të përkujdesen për vende më të varfra si Shqipëria, e cila do të vuajë pasojat më akute nga trazirat financiare dhe problemet sociale.

Meqenëse jemi në periudhën e përgatitjes për Pashkën, le të kujtojmë se Krishti i kryqëzuar dhe i ngjallur u dhuroi nxënësve të

Tij paqen dhe lirinë nga frika, duke u premtuar atyre se Ai do të qëndronte me ta në të gjitha sprovat e mundimet deri në fund të kohëve. Ne duhet të rrisim besimin tonë në praninë e Tij dhe në faktin se Ai nuk do të na braktisë në sprovat tona. Le ta kremtojmë Pashkën të lirë nga çdo sindromë frike dhe ankthi, le të bëjmë rezistencë.

Këtë vit, ndoshta nuk do të mundim ta transmetojmë dritën paskale nga një qiri në tjetrin- siç është zakoni në Kishat Orthodhokse. Në vend të saj, le të transmetojmë nga njëra zemër në tjetrën dritën e shpresës dhe të mospasjes frikë në Zotin tonë të Ngjallur.

Krishti u Ngjall!

28 mars 2020

Kisha i dhuroi Drejtorisë së Policisë, Tiranë, maska, doreza dhe dezinfektantë

Në datën 9 prill, në kulmin e masave për kufizimin e pandemisë, Kisha jonë i dhuroi Drejtorisë së Policisë të Tiranës mjete mbrojtëse, maska, doreza e dezinfektantë.

Gjatë dorëzimit, Hirësia i Tij, Asti Bakallbashi, u shpreh: “E kishim menduar prej kohësh, por tani mundëm që t’i siguronim. Ofrojmë dhe ne diçka, meqenëse ju jeni në frontin e parë të luftës. Ne ju kemi në lutjet tona të përditshme. Zoti qoftë me ju, t’ju ndriçojë dhe t’ju fuqizojë!”.

Drejtori i DVP Tiranë, Rebani Jaupi, falënderoi Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë: “Ju falënderojmë për këtë kontribut dhe që na keni futur në listën e prioriteteve, pasi misioni juaj i vërtetë është që të ndihmoni njerëzit në nevojë. Policia ka nevojë për mbështetje në këtë situatë, pasi jemi në frontin e parë të luftës kundër këtij armiku të padukshëm.



Dëshiroj që, nëpërmjet jush, t’u jap një mesazh të gjithë qytetarëve, që në këto ditë të vështira të vazhdojnë të ruajnë me rigorozitet të gjitha orientimet që jep qeveria dhe mjekësia. Të ruajmë njëri-tjetrin. Gjesti juaj, nëpërmjet këtyre mjeteve mbrojtëse, na ndihmon shumë që në kontaktin që ne kemi me qytetarët t’i mbrojmë ata, të mos i infektojmë familjarët tanë, kështu që zinxhiri të ndërpritet”.



KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË
SINODI I SHENJTË

Njoftim mbi masat mbrojtëse kundër virusit Covid-19 (Koronavirus)

Drejtuar klerit dhe besimtarëve orthodhoksë,

Me ndjenjën e përgjegjësisë dhe të dashurisë për grigjën tonë, si edhe duke vlerësuar masat e shpallura nga Organizata Botërore e Shëndetësisë dhe të institucioneve tona shtetërore e shëndetësore, për parandalimin dhe kufizimin e përhapjes së virusit Covid-19 (Koronavirus), Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë, përveç masave paraprake të para disa ditëve të pezullimit të programeve të katekizmit për të gjitha moshat, si dhe të të gjitha veprimtarive kulturore e arsimore në institucionet tona, merr këto masa shtesë:

1) Përsërisim se duhen shmangur përqaftimet, puthjet e duarve dhe çdo kontakt fizik me njëritjetrin, si dhe me objektet në kishë, të cilat mund të preken nga

të tjerët. Nderimi ndaj obje-kteve të shenjta mjafton me një përlulje para tyre.

2) Pezullohen deri në datën 3 prill 2020 të gjitha shërbesat ditore të përbashkëta nëpër kisha, si: Shërbesa e mëngjesit, e mbrëmjes, e Himnit Akathist dhe e Liturgjisë së Parashenjtuar.

3) Inkurajojmë dhe nxisim të gjithë besimtarët që këto shërbesa lutjeje t'i kryejnë në shtëpitë e tyre familjarisht ose t'i ndjekin ato në Radion "Ngjallja", në valët FM Tiranë-Durrës 88.5, Korçë 88.7, Elbasan 93.4, Fier 98.7; në internet: në Facebook Radio "Ngjallja" dhe në Web <http://www.radiongjallja.org>.

4) Për të shmangur grumbullimet e njerëzve në mensat që

ka hapur Kisha për njerëzit në nevojë, ushqimi do të përgatitet dhe do t'u jepet me vete. Për ata që nuk mund të vijnë, do të krijohet mundësia për t'ua dërguar në shtëpi.

5) Të gjitha kishat do të jenë të hapura gjatë ditës për lutje personale.

6) Misteri i Rrëfimit do të vazhdojë, por këshillojmë të ruhet distanca nga njëritjetri, si dhe të zbatohen udhëzimet e shpallura për mbrojtjen nga infektimi.

7) Vetëm Shërbesa e Liturgjisë Hyjnore e së dielës do të kryhet në të gjitha kishat. Ne besojmë se Kungata e shenjtë është burim jete dhe shërimi. Këshillojmë besimtarët e moshuar, fëmijët, si edhe ata që kanë probleme shëndetësore

të shmangin ardhjen në kishë dhe ta ndjekin Liturgjinë në valët e Radios "Ngjallja".

Dëshirojmë të theksojmë se marrja e këtyre masave të nevojshme për parandalimin e këtij virusi, si dhe zbatimi i tyre me përpikëri, është shprehje e dashurisë dhe e përgjegjësisë për të afërmin, ashtu siç na urdhëron Perëndia.

Në këto ditë të vështira, është e rëndësishme të shmangim panikun dhe të shtojmë besimin dhe lutjen personale e familjare ndaj Perëndisë, me bindjen se nuk do të na braktisë Perëndia.

**Sekretariati
i Sinodit të Shenjtë
Tiranë, 12.3.2020**

Tjetër njoftim mbi masat mbrojtëse kundër virusit Covid-19 (Koronavirus)

Duke parë situatën e re të krijuar, kur rastet me Covid-19 po shtohen, përsëri me ndjenjën e përgjegjësisë dhe të dashurisë për grigjën tonë, njoftojmë si më poshtë klerin dhe besimtarët orthodhoksë për disa masa të tjera mbrojtëse shtesë:

1) Kishat orthodhokse do të vijojnë të jenë të hapura për lutje personale. Por, për të shmangur grumbullimin e njerëzve dhe për të kufizuar kontaktet fizike, si masë për kufizimin e përhapjes së virusit, nuk do të zhvillohet asnjë shërbesë.

2) Deri në një njoftim tjetër të ri, Liturgjia Hyjnore e të dielave dhe e së kremtes së Ungjillëzimit do të kryhet vetëm në kishëzën (kapela)

e Trinisë së Shenjtë të Qendrës Sinodike në Tiranë, me dyer të mbyllura, dhe do të transmetohet drejtpërdrejt nga Radio "Ngjallja" nëpërmjet valëve FM dhe internetit.

3) Po ashtu edhe në Mitropolitë e tjera Liturgjia do të kryhet me dyer të mbyllura në kishëza (kapela) të vogla. Kujtojmë se kjo pandemi duhet të përballohet me shumë kujdes, pa panik, me lutje dhe besim te Perëndia, si edhe me dashuri e përgjegjësi të madhe për të afërmit.

Tiranë, 17.03.2020

Solidariteti do ta mposhtë pandeminë

Intervistë e Kryepiskopit Anastas për gazetën “Kathimerini” -

Zëri i Kryepiskopit të Shqipërisë, Anastasit, nga ana tjetër e linjës telefonike, na transmeton si gjithmonë paqe dhe urtësi. Si kur jemi pranë tij, ashtu edhe kur jemi larg, prania e tij na ofron qetësi dhe paqe shpirtërore në të gjitha rrethanat e vështira, aq më tepër në këtë gjendje të paparë ndonjëherë, që po e përjetojmë në nivel global. Ai vetë jeton i kufizuar, duke parë jetën e tij të përditshme që ka pësuar ndryshime të mëdha: “Edhe këtu në Shqipëri po koordinohemi me udhëzimet e qeverisë dhe ato të shëndetit publik. Komunikova pa humbur kohë me anëtarët e Sinodit të Shenjtë dhe morëm vendimet e duhura, për sa i takon shërbesës liturgjike, arsimore, katekiste dhe filantropike të Kishës sonë. Ajo që kam mësuar nga ecuria ime shumëvjeçare është që, teksa kërkojmë ndihmën e Perëndisë, të kërkojmë monopate të reja rrugëdaljesh brenda humnerave të vështirësive”.

E pyes, nëse distancimi i detyruar social për ne qytetarët ka karakteristikat e një murgërie kalimtare: “Është me vlerë të rikujtojmë se murgëria orthodhokse, së cilës iu referuat, përshkohet nga tri parime: bindja, vetëpërmbajtja dhe mospasja e pronësisë. Diçka mund të marrim nga kjo traditë e rëndësishme, siç është bindja ndaj personave përgjegjës për përballimin e situatës, bindja ndaj shkencëtarëve që merren posaçërisht me kërkimin shkencor dhe shërimin e kësaj pandemie, bindja ndaj urdhrit “Të rrimë në shtëpi”. Le të bëhet shtëpia jonë asketiri ynë.

Nuk është e lehtë. Rreziku i zënkave dhe i konflikteve për shkak të izolimit është evident. Duke qëndruar brenda në shtëpi, le të mos izolohehi. Le ta mbështesim njëri-tjetrin me fjalë, me heshtje të mbushur plot dhembshuri dhe me dëshirë të mirë e me gëzim”.

Beteja për liri

“Por, duhet pasur kujdes, - thekson ai, - që të mos kufizohemi vetëm brenda familjes sonë. Ka

dhe shumë të tjerë, që përballen me vështirësi më të mëdha. Mund t’u qasemi me anë të mjeteve moderne të komunikimit elektronik. Është nevojë urgjente që të marrim pjesë në betejën për çlirim nga frika që endet rreth nesh. Dhe në fund, le të bëhemi pak më të përkorë në jetën tonë të përditshme. Referimi juaj te murgëria, më sjell në mendje një përkufizim të mrekullueshëm nga Filokalia: “Murgu është ai që

ndahet nga të gjitha dhe që është i lidhur harmonikisht me të gjithë”.

Po si mund ta luftojmë pushtetin e vazhdueshëm të frikës, që erdhi me pandeminë? “Frika është me të vërtetë një këshilluese shumë e rrezikshme”, thekson Fortlumturia. “Depërton me mënyra të shumëllojta në mendjen dhe në vullnetin tonë, duke na ulur rezistencën. Besoj se sindroma e frikës përballohet me anë të besimit të Perëndia i Dashurisë dhe me dashurinë e shprehur në vepra: “Frikë nuk ka në dashuri, por dashuria e përsosur e nxjerr jashtë frikën” (1 Jn.4:18), na ka zbuluar Ungjillor Joani. Ne të krishterët besojmë se ndjesia e pranisë së Perëndisë na çliron nga çdo lloj frike. “Edhe po të eci në mes të hijes së vdekjes, nuk do të kem frikë të këqijat, se ti me mua je”, na thekson Psalmisti. Dhe poeti Joanis Polemis shton: “Mos ia ki frikën atij që e mbështeti besën mbi shpresën, e pashë të luftojë në jetë, por gjithnjë të pamposhtur e pashë”.

Por, për më tepër, edhe nëse dikush e dëbon ankthin rreth virusit, e shqetësojnë përsëri mendimet pesimiste për të ardhmen e ekonomisë, në një çast që dukej se do të kishim rritje ekonomike. Si do ta përballojmë? “Fillimisht, të mos i lejojnë këto mendime pesimiste që të bëhen ‘zotërinjtë’ e mendjes së tyre”, pohon ai. “Është e qartë se ky problem ekziston. Kjo pandemi nuk ka përhapur vetëm sëmundjen, por ka shkaktuar vështirësi të mëdha ekonomike, të cilat janë shkatërrimtare veçanërisht për vendet që patën së fundmi kriza ekonomike, si Greqia, apo për



...Sindroma e frikës përballohet me anë të besimit të Perëndia i Dashurisë dhe me dashurinë e shprehur në vepra... Ne të krishterët besojmë se ndjesia e pranisë së Perëndisë na çliron nga çdo lloj frike.

vende që kanë ekonomi të kufizuar, si Shqipëria. Urojmë që të gjitha qeveritë të marrin vendimet e duhura. Vendet më të pasura duhet të ndihmojnë ato më të varfra, të cilat do të përballen me

Është e qartë se tani, në këtë rast, kërkohen deklarata për detyrimet njerëzore, përgjegjësitë për shkatërrimin e ambientit dhe për ndryshimet klimatike”.

Jam i bindur se vetëm një mobilizim mbarënjëzor i solidaritetit do ta mposhtë pandeminë dhe efektet e saj anësore.

probleme më të mprehta ekonomike e sociale. Ata që kanë në dorë pasurinë botërore- shoqëritë shumëkombëshe, konsorciumet, organizmat, fondacionet, personat fizikë- duhet të ndihmojnë bujarisht në këtë situatë”.

Dhe më tej vazhdon: “Sot, koronavirusi ngjan sikur na jep këtë këshillë: “Rishqyrtoni vlerat dhe llojin e humanizmit për të cilin mburreni se e keni. Mbarënjëzimi është një familje”. Për sa i takon trajtimin terapeutik dhe përballimit të shpërthimit të kësaj pandemie, asnjë vend nuk mundet i vetëm që të ketë sukses në këtë gjë. I njëjti parim duhet të ketë vlerë edhe për kapërcimin e krizës ekonomike. Sigurisht, që ky konstatim minohet nga interesa të ndryshme individuale, sociale, etnike. Por, personalisht, besoj se e vërteta, si në shkencë, ashtu edhe në jetën sociale, ka dinamikën e saj dhe në fund fare është ajo që mbizotëron”.

Një luftë e shfaqur për herë të parë

Dhe shton: “Dy luftërat botërore sollën ndryshime rrënjësore në jetën e njerëzimit. Përmbysën aleanca, synime, teori ekonomike. Besoj se kjo luftë botërore, e shfaqur për herë të parë, do të kontribuojë në rishikimin e vlerave dhe përparësive tona. Pas Luftës së Dytë Botërore patëm një sërë deklaratash rreth të drejtave të njeriut, duke theksuar të drejtat e individit.

Besimi, antidoti më i efektshëm ndaj çdo lloji frike

“Jam i mendimit se pandemia i ka zënë në befasi shtabet e shteteve të mëdha. Nuk e kishin parashikuar këtë armik të padukshëm që nuk dorëzohet. Jam i bindur se vetëm një mobilizim mbarënjëzor i solidaritetit do ta mposhtë pandeminë dhe efektet e saj anësore. Është imperative që të rishqyrtojmë rëndësinë e humanizmit për të cilin flitet kaq shumë. Kemi nevojë për një humanizëm që respekton unitetin psikosomatik të njeriut dhe gjithë racën njerëzore dhe që siguron drejtësi për të gjithë njerëzit pa përjashtim. Idealja për mirecurinë e njerëzimit nuk mund të jetë e drejta e të fortit dhe globalizimi i teknologjisë ose i ekonomisë, por globalizimi i solidaritetit. Dhe këtu mendoj se

Idealja për mirecurinë e njerëzimit nuk mund të jetë e drejta e të fortit dhe globalizimi i teknologjisë ose i ekonomisë, por globalizimi i solidaritetit. Dhe këtu mendoj se kontributi i fesë është përcaktues”.

kontributi i fesë është përcaktues”.

Fortlumtura plotëson: “Shpirti njerëzor, në orë kritike të dhimbjes, kërkon në mënyrë spontane strehë, mbrojtje dhe ngushëllim në besimin fetar. Sa nga ne u bëmë të denjë të besojmë, e dimë se njeriu nuk është shkaku i vetes së tij. Ekziston edhe një

Realitet i Epërm. Për ne të krishterët është Perëndia i pakonceptueshëm, Qenia e vërtetë, Perëndia Triadik i dashurisë. Ai ruan një marrëdhënie të qëndrueshme me gjininë njerëzore dhe na ka dhënë të drejtën të kërkojmë ndihmën e Tij në çdo kohë e veçanërisht “në nevoja dhe në hidhërime”.

Përjetimi fetar është diçka që ndodhet brenda natyrës së njeriut. Ashtu si uji që ekziston, në forma të ndryshme, në të gjithë organizmat e gjallë, po kështu edhe feja ekziston brenda të gjitha qytetërimeve të botës, me formën e njohur ose njësoj si avujt e ujit

Besoj se kjo luftë botërore, e shfaqur për herë të parë, do të kontribuojë në rishikimin e vlerave dhe përparësive tona. Pas Luftës së Dytë Botërore patëm një sërë deklaratash rreth të drejtave të njeriut, duke theksuar të drejtat e individit. Është e qartë se tani, në këtë rast, kërkohen deklarata për detyrimet njerëzore, përgjegjësitë për shkatërrimin e ambientit dhe për ndryshimet klimatike”.

në atmosferën e shoqërive indiferente ose të pafe. Besimi që buron nga thellësitë e ndërgjegjes së krishterë, sigurisht do të kontribuojë në përballimin e sindromës së fobisë së pandemisë. Sa nga ne që kemi marrë

dhuratën e besimit, le të përkujdesemi ta zhvillojmë me përlulesi, studim dhe lutje, duke u lutur: “Zot, na shto besimin!”. Është antidoti më i efektshëm ndaj çdo lloji forme të frikës. Dhe për më tepër, të mos e lëmë pas dore lutjen për të gjithë ata që kanë vështirësi të besojnë. Është

detyrim dashurie dhe respekti ndaj tyre.

Ndërsa po afron Pashka, le të përpiqemi ta jetojmë më thellë përvojën e krishterë, që të çon nga vuajtja e Kryqit dhe nga dhimbja e Pësimit në ngazëllimin e Ngjalljes. Ngjallje të mbarë! Me dritën paskale të paqes dhe të shpresës në zemrën tonë”.

Virtytet tona

Sprova që po kalojmë, ka ndihmuar në zgjimin e solidaritetit. A do të vazhdojë kjo edhe në të ardhmen?

- Në fatkeqësitë e mëdha, burojnë virtyte të mrekullueshme nga ndërgjegjja e popullit, si sedra e mirë, solidariteti, vetësakrifica. Shikoni, ADN - ja e ndikuar nga besimi i krishterë ka koncentruar vlera unikalë. Shpesh kam formuluar pikëpamjen se armiku i vërtetë i çdo lloji paqeje nuk është lufta, por egocentrizmi individual, racor, kombëtar, fetar. Dhe se antidoti është solidariteti që frymëzon dashuria, plotësinë e së cilës na e zbuloi Krishti. Lulëzimi i solidaritetit është një fenomen optimist. Tani, se sa do të zgjasë në të ardhmen, nuk e di. Megjithatë, jam i bindur se të gjithë duhet të përpiqemi për të stabilizuar vlerat e krishtera me rëndësi botërore.

U hap në Bialystok, Poloni, ekspozita “Ngjyrat e Orthodhoksisë. Shqipëria”

Më 23 shkurt 2020, në Qendrën Kulturore Orthodhokse të qytetit Bialystok të Polonisë, u çel ekspozita “Ngjyrat e Orthodhoksisë. Shqipëria”. Ekspozita u ndërthur edhe me promovimin e botimit të albumit fotografik me të njëjtin titull.

Albumi dhe ekspozita përbëjnë vëllimin e nëntë të serisë “Ngjyrat e Orthodhoksisë”, që ka për qëllim të promovojë shumëngjyresinë e Orthodhoksisë në Kishat lokale. Ky vëllim ishte produkt i bashkëpunimit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë dhe Kishës Orthodhokse të Polonisë përmes Shtëpisë Botuese Mitropolitane në Varshavë dhe të portalit orthphoto.net.

Aktiviteti u çel me interpretime korale nga një formacion i përzgjedhur i korit “Kaladniki”, të Katedrales së Shën Nikollës në Bialystok, Poloni. Në vijim, Kryedhjakon Spiro Topanxha lexoi fjalën përshëndetëse të rastit të Kryepiskopit të Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Fortlumenturisë së Tij, Anastasit, i cili,

ndër të tjera, theksoi: “*E vërteta, dashuria dhe bukuria në Orthodhoksi ecin së bashku... Albumi fotografik “Ngjyrat e Orthodhoksisë. Shqipëria”, ofron një dëshmi tjetër të pranisë së përhershme të bukurisë në shprehjet e ndryshme të spiritualitetit dhe jetës orthodhokse. Nuk janë vetëm kishat e mahnitshme, ikonat e mrekullueshme dhe krijimet e tjera artistike që lidhen me jetën adhuruese orthodhokse. Është, gjithashtu, bukuria e pafajësisë dhe e gëzimit që shkëlqen në fytyrat e fëmijëve, e durimit dhe e qëndresës, që rrezaton në pamjen e të moshuarve në çastin kur ndezin një qiri, i falen një ikone apo teksta kungohen... Kisha e Shqipërisë, që nga ringritja e saj, ka zhvilluar marrëdhënie vëllazërore me Kishën Orthodhokse të Polonisë, si edhe me të gjitha Kishat e tjera Orthodhokse lokale. Bashkëpunimi me Fortlumenturinë e Tij, Mitropolitin e Varshavës dhe të Gjithë Polonisë, Sava, është i gjithanshëm dhe krijues...*

Fotot e albumit dhe të ekspozitës flasin për çaste domethënëse nga ecuria historike plot me mundime e Kishës Orthodhokse në Shqipëri. Të gjitha sa ndodhin në çdo Kishë Orthodhokse lokale, përbëjnë faqe të një Orthodhoksie të vetme dhe kanë lidhje me të gjithë besimtarët, qelizat e gjalla të trupit të Kishës në mbarë globin. Seria e botimeve “Ngjyrat e Orthodhoksisë” na zbulon larminë, harmoninë dhe unitetin e Orthodhoksisë, duke na ofruar edhe një dëshmi të saj estetikisht të bukur. Bukuria orthodhokse mjaft e larmishme është një reflektim i zbehtë i rrezatimit të lavdisë së pashprehshme të Perëndisë Triadik, i dashurisë së Atit, siç na zbulohet me anë të pranisë së vazhdueshme të Birit dhe të Fjalës së Tij, Kryes së Kishës dhe që vazhdon të zbukurojë e të transformojë shpirtin të panumërt dhe mbarë botën me veprimin dhe hirin e Shpirtit të Shenjtë”.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga z. Arbër Veizi, përfaqësues i

Ambasadës Shqiptare në Varshavë.

Jaroslav Charkiewicz nga Shtëpia Botuese Mitropolitane dhe Aleksander Wasyluk nga portali OrthPhoto së bashku me partnerët nga Shqipëria, Kryedhjakon Spiro Topanxha dhe z. Andi Rembeci, historian-bizantolog dhe pedagog në Universitetin e Tiranës, prezantuan historinë e punës për mbledhjen e fotografive, zhvillimin e konkursit ndërkombëtar të fotografisë, botimin e albumit dhe organizimin e ekspozitës.

Motër Katerina, igumene e manastirit të Shën Ekaterinës në Zaleszany, prezantoi historinë e ringritjes së Kishës Orthodhokse në Shqipëri si dhe figurën dhe veprën e lartë të Kryepiskopit Anastas. Në vijim, u shfaq një dokumentar për ringritjen e Kishës Orthodhokse në Shqipëri.

Aktiviteti u mbyll me një koktej dhe me vizitën e ekspozitës fotografike nga të gjithë të pranishmit.



Mensa e Kryepiskopatës së Tiranës “Shërbimi i Dashurisë”, funksionoi edhe në këto ditë të vështira

Edhe në këtë periudhë të vështirë, të krijuar nga epidemia e Covid-19 dhe masat kufizuese, Mensa e Kryepiskopatës së Tiranës, “Shërbimi i Dashurisë”, vazhdon t’u vijë në ndihmë njerëzve në nevojë.

Për shkak të situatës së krijuar, tashmë ushqimi ofrohet sipas një skeme të re organizimi. Me ndihmën e stafit të mensës dhe vullnetarëve, ushqimi përgatitet dhe paketohet i ngrohtë për personat

në vështirësi. Këta marrin ushqim jo vetëm për vete, por edhe për familjarët (rreth 250-280 racione ditore)

Duhet të theksohet kontributi i çmuar i dhuruesve të shumtë, si brenda vendit, ashtu edhe nga diaspora, të cilët, sipas mundësive të tyre, e kanë mbështetur pa u kursyer dhe vazhdimisht mensën.

Personeli i mensës kujdeset që t’u shërbejmë të gjithëve në mënyrë sa më dinjitoze, që çdo-

kush të largohet i kënaqur nga ambientet e saj.

Shembulli dhe nxitja në këtë vepër në ndihmë të më të dobëtëve është Kryepiskopi Anastas, i cili e ka mbështetur vazhdimisht funksionimin e saj.

Mensa “Shërbimi i Dashurisë” mirëpret dhurimet tuaja të vlefshme, që të vazhdojë me dashuri t’u shërbejë e t’u vijë në ndihmë të gjithë atyre që kërkojnë ushqim e ngrohtësi pranë saj.

Dhurimet mund të bëhen në:
Nr. Llogarie në UNION BANK:
111485096020314 KISHA ORTHODHOKSE AUTOQEFALE E SHQIPËRISË, Për mensën “Shërbimi i Dashurisë”

IBAN:
AL39214111060111485096020314
Kodi SËIFT: UNALALTRXXX
Numër kontakti: 0674080729
Mund të na shkruani dhe në inboxin e faqes në Facebook: Mensa Shërbimi i Dashurisë - Kryepiskopata e Tiranës.



Në mensën “Shërbimi i Dashurisë”, në Tiranë, nevojtarët marrin ushqim jo vetëm për veten, por edhe për familjarët (Përgatiten rreth 250-280 racione ditore)

RESTAURIMI NË PROCES I KISHËS SË SHËN NIKOLLËS NË PORTO PALERMO, HIMARË

Kisha e Shën Nikollës ndodhet në gjirin e Porto Palermos, i cili është i njohur që në kohët e lashta si gjiri Panorma dhe shtrihet në juglindje të qytetit të Himarës, në brigjet e detit Jon. Gjiri Panorma është me origjinë tektonike, i identifikuar si bregdet i thepisur dhe i paraqitur dhe në hartat e vjetra. Brenda gjirit ndodhet një gadishull i vogël dhe tërheqës shkëmbor, i cili hyn rreth 300 metra në det. Këtu ndodhet dhe kalaja e njohur.

Objekti ndodhet buzë rrugës nacionale Vlorë-Sarandë, rreth 8.5 km larg qendrës së Himarës. Kisha rrethohet nga disa objekte të ndërtuara gjatë periudhës së komunizmit, atëherë kur e gjithë zona rreth saj u shndërrua në bazë ushtarake detare.

Kisha e Shën Nikollës është i vetmi element që ka mbetur nga manastiri dikur i ndritshëm i Shën

Nikollës së Panormës. Kjo dëshmohej nga burime të shkruara dhe gjetje të tjera. Bëhet fjalë edhe për përshkrimet tejet argumentuese që na japin udhëtarë dhe historianë të huaj që kanë kaluar në atë zonë. Informacioni bazë që na shpie në

përfundimin se kisha që sot ka shpëtuar është kishatoni i një institucioni monastik, vjen nga libri i hulumtuesit dhe theologut, Theofan Popa, i cili u referohet mbi-shkrimeve të manastireve dhe kishave të Shqipërisë. Këto mbishkri-

me, i ndjeri Popa i ka mbledhur nga shënime të Pulitsës, të botuara më parë, si edhe nga kërkime të tij të drejtpërdrejta në terren si nëpunës i Institutit të Monumenteve të Kulturës, në periudhën e persekutimit ateist. Popa gjeti një kuti lipsanesh të shenjta në manastirin e Shën Dhimitrit në Qeparo, në të cilën shkruhej në greqisht: “Kjo kuti lipsanesh është e manastirit të Shën Nikollës – Palermo, 1800”.

Në një ballafaqim me një tjetër mbishkrim që referon libri “1811”, që ishte e murosur në një gur qosheje në konakët e manastirit të Shën Dhimitrit, mund të mbështetet hipoteza se, pasi Ali Pashë Tepelena shkatërroi manastirin e Shën Nikollës në Palermo, sikundër do të përshkruhet më poshtë, murgjit transferuan çka kishin shpëtuar nga manastiri në Palermo dhe

(Vijon në faqen 14)



(vijon nga faqja 13)

ndërtuan rreth kishës së Shën Dhimitrit, e cila ekzistonte prej kohësh, konakët për t'u vendosur atje. Kështu kutia e lipsaneve u gjend në atë vend nga Popa rreth vitit 1970.

Poukevili, prift francez dhe diplomat – konsull i Francës në oborrin e Ali Pashës rreth vitit 1811 vizitoi trevën e Himarës dhe mbajti shënime, të cilat i botoi më vonë në Paris, më 1820. Poukevili na jep një përshkrim të përsosur të peizazhit të gjirit të Panormës, të kështjellës dhe të rripit të ngushtë të tokës që e lidh atë me sterenë, pikërisht atje ku ndodhet kisha e Shën Nikollës dhe disa kasolle, që janë mbetje nga godina të tjera të manastirit të vogël që ishte atje. Duhet theksuar se rreth vitit 1798 Ali Pasha e mori trevën e Himarës dhe në vitin 1806 ndërtoi kështjellën. Në këtë kështjellë qëndroi Poukevili. Pra, më 1811 kisha e hirshme e Shën Nikollës me disa kasolle përreth ishte atje.

Faktet dëshmojnë për një përpjekje disaditore të Ali Pashës për të rrënuar krejt kishën dhe godinat e tjera përreth manastirit të vogël. Spiro Llambro, letrar dhe historian epirotas, shumë pranë në kohë me ngjarjet, përshkruan në librin e tij “Himara” se, për tri ditë, ushtarët e Aliut gjuanin me top kishën nga një anije e ancoruar në gji, ngaqë ajo pengonte planin e tij për të ndërtuar kështjellën mbi gërmadhat e së vjetrës. Kisha, me sa duket, si në një mrekulli i mbijetoi goditjeve me top dhe përpjekjeve për shembjen e saj dhe kështu, pavarësisht nga dëmtimet, ruhet deri më sot.

Nuk përjashtohet mundësia, me sa dëshmojnë elementet arkitektonike, që të dispononte edhe kube qendrore, duke i ngjarë kështu kishave të tjera manastiriale të asaj periudhe (shek. XVII-XVIII): “Shën Dhimitri” në Qeparo, “Fjetja e Perëndilindëses” në Kakome, “Shën Jorgji” në Vollodër, “Shën Vasili” në Shën Vasil etj., në të njëjtën vijë të rajonit bregdetar. Ka të ngjarë që bombardimet me top nga anije të ushtarëve të Ali Pashës,

sipas dëshmimeve historike, ia dolën të rrëzonin kubën dhe, gjatë rikuperimit të kishës së hirshme, ajo nuk u rindërtua, por duhet të jetë mbyllur hapja në harkun e qemerit të mbulesës së nefit kryesor të kishës.

Në vijim, kisha u përdor gjatë gjithë kohës si paraklis nga besimtarët e fshatrave kufitare, kryesisht të Qeparoit dhe të Himarës, dhe si një faltore e të gjithë zonës atje.

Në vitet që pasuan (mesi i shek. XX), me stabilizimin e shtetit komunist në Shqipëri, e gjithë zona rreth “Shën Nikollës” u shndërrua në bazë ushtarake detare, që nga dhjetëvjeçari '60. Rruga që shpie në Himarë dhe në vazhdim në Vlorë kalonte nga Gryka e Kudhësit dhe lartësitë e Pilurit. Për pasojë, kisha së bashku me pasurinë që dispononte u shtetëzua dhe e gjithë zona iu nënshtrua transformimeve të mëdha, si rezultat i të cilave sot nuk është e mundur të gjenden të tjera gjetje apo gërmadha të godinave përreth saj. Vetë kisha u shndërrua në depo të materialeve luftarake, pasi paraprakisht ishte zbrazur nga relike të vlefshme kishtarë që përmbaheshin atje. U hoqën, natyrisht, kambaneria, kryqet dhe çatia me tjegulla, që u zëvendësua me soletë betoni antiestetike dhe të ndërtuar pa mjeshteri. Me rënien e sistemit komunist, ndonëse zona vazhdonte të qëndronte e kontrolluar për qarkullimin e lirë, banorët filluan, të ndrojtur, të vinin në kishë dhe sidomos pas vitit 1997 kur u “hap” zona në mënyrë më të rregullt u rikthyen në Faltoren e tyre, duke vijuar përpjekjen për të zgjidhur dhe rregulluar edhe çështje të zotërimit të pasurisë.

ANGAZHIMI DHE PËRMBUSHJA E PROCEDURAVE TEKNIKE E FINANCIARE

Besimtarë dhe dashamirës të kësaj kishë, prej vitesh kërkonin me interesim të veçantë restaurimin e saj. Për këtë, ata kishin mbledhur edhe një kontribut, i cili, me anë të atë Jani Mërkurit, iu vu në dispozicion Kishës Orthodhokse Auto-



Kisha e Shën Nikollës, që po restaurohet dhe pamje e gjirit të Panormës (Palermos).

qefale të Shqipërisë. Duke parë këtë interesim, Kryepiskopi Anastas i kërkoi Bërthamës së Trashëgimisë Kulturore të Kryepiskopatës fillimin e procedurave për realizimin e projektit dhe miratimin e tij më pas në Këshillin Kombëtar të Restaurimit të Ministrisë së Kulturës. Pas kësaj, Kryepiskopi akordoi pjesën më të madhe të shumës së preventivuar për realizimin e këtij restaurimi, e cila, duke iu bashkëngjitur asaj të besimtarëve, mundësoi fillim e punimeve në kishë.

NDËRHYRJET E PROPOZUARA QË AKTUALISHT PO ZBATOHEN

- Zbankim dhe pastrim shkurresh.

- Rikonstrukcion i plotë i çatisë, mbulimi i saj me tjegulla vendi. Kjo do të bëhet duke ruajtur me rigorozitet kuotat ekzistuese të këtij objekti. Para këtij rikonstrukcion do të çmontohet betoni, i cili, në mënyrë të çuditshme, ka mbuluar gjithë sipërfaqen aktuale të çatisë.

- Do të realizohet përforcimi i konstruksionit ekzistues nëpërmjet përforcimit të qemerëve të mbulesës.

- Gjendja e muraturës paraqitet e mirë, nevojiten disa injektime dhe fugatime.

- Do të plotësohen të gjitha elementet që i japin formën dekorative të katër fasadave, të cilat vende-vende janë dëmtuar.

- Duke parë lagështinë që krijohet në pjesën e poshtme të mureve, përveç pastrimit të përgjithshëm do të realizohet një sistemim i jashtëm i drenazhimit, sipas detajit të mëposhtëm:

- Ndërhyrja do të plotësojë me dyer dhe dritare druri të gjithë objektin.

- Riparimi i suvasë së brendshme të mureve dhe tavanit.

- Riparimi i fugaturës së mureve, muri në përgjithësi është i rregullt, por fugat janë të degraduara dhe të shpëlarë për shkak të ujërave që kanë shpëlarë materialin lidhës.

Është parashikuar realizimi i murit mbajtës të dherave, sidomos në anën lindore të objektit, pasi, ashtu siç është evidentuar dhe më lart, në këtë zonë ka prani të masave të dheut dhe bimësisë së lartë. Gjithashtu është parashikuar realizimi i një muri mbajtës dhe në pjesën perëndimore, meqenëse ka disnivel dherash dhe duhet të bëhet disiplinimi i tyre për të lehtësuar afrimin në kishë.

Për Bërthamën e Trashëgimisë Kulturore Përgatiti: Ark. Rest. Gentian Stratobërdha

Për riintegrimin e të kthyerve nga emigracioni

Diakonia Agapes - zyra sociale, zhvilluese dhe e emergjencës e Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, që prej 1 marsit 2019 po zbaton në Bashkinë Belsh, Cërrik dhe Përrenjas projektin “*Ri-integrimi i të kthyerve nga emigracioni dhe investimi për ta në Shqipëri*” (RE-IN-VEST), që financohet nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim të Gjermanisë, në kuadër të programit “Rikthim të Mundësitë e Reja”, zbatuar nga GIZ. Ky projekt zbatohet nga World Vision në partneritet me Shoqatën Kombëtare “Edukim për Jetën” dhe Fondacionin “Fryma e Dashurisë” - Diakonia Agapes.

Projekti synon të përmirësojë kushtet e jetesës së të kthyerve nga emigracioni, duke lehtësuar aksesin e tyre ndaj shërbimeve sociale dhe duke u krijuar mundësi për gjenerim të ardhurash të qëndrueshme. Përqasja e përdorur, vendos në qendër familjen dhe ofron mbështetje social-ekonomike, trajnime profesionale si edhe synon fuqizimin ekonomik të pjesëtarëve të familjes nëpërmjet punësimit dhe përkrahjes së ideve të biznesit. Gjithashtu, synon të krijojë një rrjet të qëndrueshëm e bashkëpunues midis partnerëve lokalë dhe rajonalë, në mënyrë që të lehtësohet koordinimi dhe aksesueshmëria e shërbimeve, riintegrimi i fëmijëve në sistemin arsimor dhe të nxitet punësimi në nivel vendor.

Gjatë kësaj periudhe, Diakonia Agapes ka realizuar një sërë aktivitete me grupe individësh si burra, gra, fëmijë e të rinj të rikthyer nga emigracioni, si dhe ata më vulnerabël dhe në risk për emigrim në bashkitë e synuara nga projekti. Pas identifikimit të familjeve të rikthyer me bashkëpunimin e ngushtë të institucioneve të ndryshme publike në këto bashki, ata janë përfshinë gjerësisht në aktivitete, të cilat kanë ndikim në jetën e tyre.

Mbështetja me “Menaxhim Rasti” e 68 familjeve (247 persona) të rikthyer nga Gjermania, por edhe disa vulnerabël me pako ushqimore dhe higjienike gjatë periudhës gusht 2019 - janar 2020 ku përfitues ishin nga Bashkia Belsh (87 persona), Bashkia Cërrik (66 persona) dhe Bashkia Përrenjas (94 persona). Për shumë nga ata ishte hera e parë që dikush u trokiti në derën e shtëpisë dhe u ofroi ushqime për vete dhe familjet e tyre, duke mos kërkuar asgjë në këmbim - kështu shprehet një nënë e rikthyer nga Gjermania në Bashkinë Përrenjas. Në kuadër të këtij aktiviteti të tjerë individë janë referuar në institucionet përkatëse për pajisjen me karta shëndeti apo



në zyrat e punës, apo biznese private për punësim. Falë përpjekjeve të Diakonia Agapes, 3 individë në Bashkinë Përrenjas janë punësuar në biznese private duke përmirësuar kushtet e tyre të jetesës. Mbështetja do të vazhdojë edhe me ofrimin e bonusit të qirave për familjet e rikthyer që s’kanë mundësi të paguajnë apo mbështetje me medikamente për raste specifike.

Janë kryer trajnime të ndryshme me tematika për: “Disiplinimin pozitiv, komunikimin në familje, menaxhimi financiar të familjes dhe ushqyerjen e shëndetshme”. Rreth 60 nëna të rikthyer nga bashkitë e Cërrikut, Belshit e Përrenjasit, u përfshinë dhe shkëmbyen përvojat mes tyre gjatë trajnimeve dyditore të realizuara gjatë periudhës nëntor 2019 - shkurt

2020. Nënata kanë rritur nivelin e njohurive të tyre se si të komunikojnë në familje dhe të krijojnë një mjedis të shëndetshëm dhe një familje të lumtur, pavarësisht sfidave që u dalin tani që janë rikthyer. Gjithashtu, 10 familje (39 persona) nga Bashkia Belsh dhe Përrenjas, pjesë e projektit RE-INVEST, morën pjesë në një trajnim treditore “Të festojmë familjen” të organizuar në Shën Vlash, Durrës. Ata janë përfshirë në një rrugëtim ku kanë rikujtuar të shkuarën, kanë kuptuar më mirë fëmijërinë dhe kanë vlerësuar rëndësinë e përvojave të tyre të mënyra sesi i rrisin fëmijët sot. Ky reflektim ka ndihmuar prindërit e rikthyer, veçanërisht ata në risk për të emigruar, të

iniciativa për komunitetin e tyre. Rreth 45 të rinj të grupmoshës 15 - 18 vjeç nga Bashkia Cërrik dhe Përrenjas morën pjesë në një kamp treditore me fjetje, ku patën mundësi të shpërndanin eksperiencat e tyre, vështirësitë e rikthimit, përjashtimin social etj. Rreth 146 fëmijë të moshës 6-14 vjeç u përfshinë në kampe treditore të organizuara nga Diakonia Agapes në secilën bashki për të zbutur problematikat sociale të këtyre fëmijëve, si dhe për ta bërë më të suksesshëm riintegrimin e tyre.

Një aspekt mjaft i rëndësishëm në këtë projekt është edhe komponenti ekonomik, për fuqizimin ekonomikisht të familjeve të rikthyer, për të siguruar qëndrueshmëri financiare në jetën e tyre. Pas procesit të identifikimit, Diakonia Agapes realizoi gjatë muajve dhjetor 2019 – janar 2020, në bashkitë Përrenjas, Belsh dhe Cërrik, trajnime 6-ditore për ngritjen e kapaciteteve për shkrimin e bizneseve bazuar në metodologjinë CEFE. Rreth 73 individë të rikthyer nga emigracioni, por jo vetëm, si edhe individë vulnerabël në komunitet nga këto bashki, të cilët kishin një ide biznesi, si dhe që duan t’i japin

gëzojnë marrëdhëniet e krijuara në familje për t’i dhënë shpresë dhe vizion së ardhmes.

Diakonia Agapes, në bashkëpunim me rreth 148 të rinj të moshave 12-18 vjeç, ka krijuar gjashtë grupe rinore ose Klube IMPACT-i në Bashkinë Cërrik, Përrenjas dhe Belsh. Qëllimi i këtyre është ngritja e kapaciteteve dhe zhvillimi i të rinjve për t’u bërë qytetarë aktivë përmes modelit social IMPACT që janë duke ndjekur, do t’u sigurojë të rinjve njohuri, aftësi, sjellje dhe qëndrime të nevojshme që u duhen në jetë për të ndihmuar komunitetin e tyre. Secili grup drejtohet nga 2 liderë të certifikuar mbi modulet IMPACT dhe është mirëpritur nga të rinjtë pasi ky model iu ofron diçka ndryshe, si dhe do të kenë mundësi për t’u ndërmarrë

një kthesë jetës së tyre, u trajnuan për herë të parë mbi këto tematika. Rreth 21 individë do të mbështeten financiarisht me start-up, duke siguruar vetëpunësim dhe fuqizimin ekonomik të familjes në komunitetet ku jetojnë.

Bashkëpunimi me institucionet publike, si dhe ngritja e kapaciteteve të rreth 60 punonjësve të institucioneve publike në lidhje me çështjet e riintegrit, ka qenë një nga pikat e forta të projektit. Diakonia Agapes ka realizuar një numër të madh takimesh e bashkëpunimesh në nivel vendor për të arritur një impakt sa më të madh në jetën e këtyre komuniteteve. Diakonia Agapes do të vazhdojë aktivitetet e saj në kuadër të projektit RE-INVEST deri më 31 gusht 2020.



Shkolla Normale e Elbasanit u hap në një godinë të vënë në dispozicion nga Komuniteti Orthodhoks dhe pati mbështetjen e plotë të besimtarëve e klerikëve orthodhoksë. (Por sot vazhdohet me këmbëngulje që të mohohen të drejtat e Kishës për këtë godinë të saj, megjithëse i është mohuar pronësia ligjrisht)

Veprimtari në Kolegjin Universitar “Logos”, në kuadrin e “Javës së Harmonisë Ndërfetare Botërore”

Me rastin e Përvjetorit të dhjetë të Javës së Harmonisë Ndërfetare Botërore, Departamenti i Theologjisë dhe Kulturës i Kolegjit Universitar “Logos” organizoi më 3 mars një tryezë të rumbullakët me temë “Marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërreligjioz në Shqipëri. Historia dhe perspektivat moderne”. Kjo veprimtari u zhvillua në kampusin qendror të Kolegjit Universitar “Logos”, në bashkëpunim me Departamentin e Studimeve Islame të Kolegjit Universitar “Bedër”, Seminarin Katolik të Shkodrës dhe Vëllazërinë Ungjillore të Shqipërisë.

Diskutimi kryesor ishte shqyrtimi se si ka funksionuar kjo tolerancë fetare dhe bashkëjetesë në Shqipëri dhe cilat janë pikat etike që bashkojnë komunitetet fetare si bazë e bashkëpunimit dhe bashkëjetesës së tyre sot dhe në të ardhmen.

Pas një prezantimi të shkurtër nga Drejtuesi i Departamentit të Theologjisë dhe Kulturës (Kolegji Universitar “Logos”), Dr. Georgios Gaitanos, për modelin e tolerancës fetare në Shqipëri dhe qëllimet e objektivat e Javës së Harmonisë Ndërfetare Botërore, morën fjalën dhe prezantuan temat e tyre pjesëmarrës nga Kolegji Universitar “Logos” (Msc. Dhimitër Qosja), Kolegji Universitar “Bedër” (PhD. Cand. Hysni Skura), Seminari ndërreligjioz “Nëna e Këshillit të Mirë”, Shkodër (Dom Lorenzo Rossetti) dhe Instituti i Studimeve Shqiptare dhe Protestante (IAPS) (Dr. John Quanrud).

Pas prezantimeve dhe diskutimit me studentët dhe kolegët që morën pjesë në tryezën e rumbullakët, u konkludua se prania dhe bashkëjetesa

në vendin tonë e dy feve më të mëdha monoteiste, Islamit dhe Krishterimit, e ka bërë tolerancën dhe mirëkuptimin ndërfetar një domosdoshmëri historike. Kjo ka shërbyer si një faktor i rëndësishëm, që ka siguruar ekzistencën dhe unitetin e popullit tonë si një komb, duke i dhënë asaj një vlerë shekullore dhe të patjetërsueshme, për të cilën shumë vende kanë nevojë të ngutshme dhe e kërkojnë dëshpërimisht.



Çaste nga veprimtaria në Kolegjin Universitar “Logos”

Mbishkrimet në greqisht në Shqipëri, dritare njohjeje me të shkuarën

Gjuha greke, ndër shekuj ka dhënë kontribut thelbësor në konsolidimin e kulturës evropiane dhe botërore. Bëhet fjalë për një gjuhë që flitet pa ndërprerje për 40 shekuj, me gjithë ndryshimet që pësoi radhazi gjatë katër fazave të ndryshme – antikitetit, epokës hellenistike, botës mesjetare dhe kohës së re. Në kohërat e lashta, gjuha greke arriti të bëhej bartëse e formulimit dhe transmetimit të teorive bazike shkencore, atyre filozofike dhe teksteve letrare. Ish-te gjuha e pasur e letërsisë, përmes së cilës na lanë veprat e tyre filozofë, poetë dhe shkrimtarë të mëdhenj, si Platoni, Thukididi, Eskili, Aristofani, Hipokrati dhe shumë të tjerë. Është njëherazi gjuha e saktë e shkencës, në të cilën u formësua koncepti dhe mendimi shkencor që nga kohërat e lashta dhe me të cilën u krijuan kushtet për zhvillimin e shkencave moderne me krijimin e mjeteve të nevojshme konceptuale, që ende sot furnizojnë shkencën ndërkombëtare me terminologji të reja. Në greqisht, u shkruan ca më vonë tekstet më të rëndësishme të Krishterimit për t'u përhapur në të gjithë botën.

Prania e greqishtes në hapësirat ilire gjatë antikitetit dëshmon kontaktin dhe marrëdhëniet shumë të hershme të grekëve me ilirët dhe të ndikimit të kulturës së tyre në kohët antike. Edhe më pas, përgjatë shekujve mesjetarë, roli dhe ndikimi i greqishtes në Arbëri, si gjuhë zyrtare e shtetit dhe civilizimit bizantin, ka qenë i dukshëm. Për mbi 10 shekuj, tokat shqiptare kanë qenë pjesë e Perandorisë Bizantine. Kjo periudhë e gjatë dhe e rëndësishme e historisë mesjetare të arbërve gjendet e pasqyruar në faqet e burimeve të shumëllojta bizantine në greqisht, si histori politike e kishtarë, kronika, shkresa dhe akte zyrtare të perandorëve, kancelarive dhe institucioneve shtetërore e kishtarë, fjalime e ligjërata

politike, monumente ligjore, manuale ushtarake e administrative, jetëshkrime shenjtore etj. Kujtojmë, me këtë rast, se njoftimet bizantine në greqisht janë të parat në mesjetë që i përmendin pasardhësit e ilirëve me emrin arbër. Po ashtu, burimet bizantine në greqisht dokumentojnë ekzistencën e arbërve që nga mesjeta e her-



*Mbishkrim kushtimi në ikonën e Shën Dhimitrit, shek. XIX.
Koleksioni i Galerisë së Arteve, Tiranë.*

shme si një popullsi më vete, me tipare dhe karakteristika të veçanta, që dallohen ndërmjet popullsisë të tjera të Perandorisë multietnike Bizantine.

Siç kuptohet, ndikimi i civilizimit bizantin, gjatë dhe pas Bizantit, ka qenë dinamik, duke na lënë gjurmë të forta që ruhen ende sot në një pjesë të madhe të trashëgimisë kulturore. Pikërisht, një gjini e përveçme e kësaj trashëgimie janë mbishkrimet e monumenteve të krishtera të periudhës bizantine dhe pasbizantine. Ato janë përgjithësisht tekste të shkurtra në greqisht, që përmbajnë të dhëna lidhur me ndërtimin, rindërtimin, pikturimin dhe zburimin e kishave në vend. Gjenden në monumente të tundshme dhe të patundshme kulturore dhe përmendin emrat e ndërtuesve, piktorëve, mjeshtërve ndërtues si edhe emrat e klerikëve ose laikëve, të huaj apo vendas, që administronin apo

kryesonin kohë pas kohe në pozita të caktuara vetadministruese apo kishtarë, që luanin një rol të rëndësishëm në qeverisjen e vendit, ose që patën qenë patronë apo dhurues të monumenteve të ndryshme ku gjenden mbishkrimet.

E gjithë larmia e mbishkrimeve kishtarë në vendin tonë, të shkru-

paraqitjet e shenjtoreve, përmbajnë citate agjiografike, paraqesin pjesë himnologjike, pjesë nga urtësia e Etërve të Kishës etj.

- *Mbishkrime kushtimesh (dhurimesh)*, gjenden kryesisht në sipërfaqet e kufizuara të mureve të kishave, në pikturat murale, në objekte të lëvizshme (ikona, epitafe të qëndisura etj.), në metale të përpunuara (kuti lipsanesh, enë kishtarë, bazamente kryqesh, kambana, temjanica) etj. Këto mbishkrime përmbajnë, gjithashtu, informacione lidhur me mënyrën dhe masën e shtrirjes së fenomenit të islamizimit, me marrëdhëniet mes të krishterëve dhe të islamizuarve, me sjelljen e këtyre të fundit ndaj monumenteve dhe zakoneve të zonës, me taksat, dhënie të ndryshme, onomatologjinë e banorëve, antroponimet popullore të grave dhe burrave, shqiptimin e toponimeve, lidhjet farefisnore etj.

ara në greqisht, mund të ndahet në këto kategori:

- *Mbishkrime ktitorike*, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm historik me vlerë jo vetëm për vetë monumentin ku ato gjenden, por edhe për kuadrin e përgjithshëm historiko-social, brenda të cilit u krijuan këto vepra. Ato ofrojnë të dhëna lidhur me gjendjen ekonomiko-sociale, me administrimin kishtar dhe me peripecitë historike të vendeve, duke regjistruar ktitorë e pronarë, dhurues e përkushtues, piktorë, datime të ngritjes së monumentit, klerin, episkopë dhe, herë-herë, epitropë, igumenë, murgj etj.

- *Mbishkrime liturgjike*, të cilat zënë një vëllim të konsiderueshëm në lëmin e mbishkrimeve. Këto mbishkrime, duke qenë pjesë e pandashme e pikturave murale, titullojnë kompozimet pikturale, emërtojnë

- *Shënime kronike*, të cilat ndodhen në muret e kishave, në regjistra, pllaka, kodikë dhe i referohen ngjarjeve të ndryshme, si uri, epidemi, luftëra, ndryshime episkopatash, robërime, taksa, marrëdhënie mes vendeve me bejlerë apo pashallarë, ngjarje të rëndësishme, shitje-blerje etj.

Rëndësia e mbishkrimeve në greqisht për historinë kishtarë

Mbishkrimet në greqisht, për vetë nga natyra e monumenteve ku ato ndodhen, kanë së pari rëndësi për historinë kishtarë vendore. Të rëndësishme janë të dhënat që ato ofrojnë për episkopatat e vjetra dhe episkopët në territorin shqiptar, për kufijtë administrativë kishtarë etj. Për shembull, në mbishkrimin e epitafit të Gllavenicës, ku përmendet emri i episkopit Kalist, rezultojnë

(vijon në faqen 18)

(vijon nga faqja 17)

se Gllavenica, më 1373, ishte një qendër shumë e rëndësishme episkopale, aq sa prej saj varej edhe episkopata e Beratit, qendër e njohur për traditën kishtarë. Gjithashtu, nga mbishkrimet në greqisht të shek. XVII-XIX rezultojnë të dhëna për episkopatën e Durrësit, Beratit, Korçës, Drinopojës, Delvinës dhe Himarës, Gorës dhe Mokrës, Stefaniakës dhe Bendës. Mbishkrimet e shpëtuara të shek. XVI nuk flasin për episkopata apo episkopë, me përjashtim të dy mbishkrimeve: të kishës së Shën Marisë në Episkopi të Sipërme, në Rrizë të Zezë të Gjirokastrës (1510) dhe të kishës së Shën Dhimitrit në Poliçan të Pogonit, të cilat përmendin si episkop Simeonin e Drinopojës. Mungesa e emrave të primatëve të episkopatave mund të ketë ndodhur për shkak se, pas pushtimit osman, episkopatat në territorin shqiptar mbetën për ca kohë pa primatë, por edhe për shkak se, në raste të caktuara, iniciativat vendore ekzekutoheshin pa informuar për to primatët e episkopatave. Në mbishkrimet e periudhave të mëpasshme numërohen mbi 26 episkopë orthodhoksë, që kanë shërbyer në mitropolitë dhe episkopatat e ndryshme të hapësirës shqiptare nga shek. XVI-XIX.

Në mbishkrimet murale në greqisht, informacione me mjaft interes ofrohen edhe për njohjen me administratën dhe postet kishtarë, me manastiret dhe veprihtaritë e tyre në territorin shqiptar. Në to ndeshen tituj e ofiqe, si: “*igumen*”, “*ikonom*” (titull priftëror për klerikë që merren me menaxhimin e çështjeve ekonomike), “*saqellar*” (ofiq i vjetër kishtar, që i jepej klerikëve që kishin detyrë të mbikëqyrnin manastiret e një episkopate), “*mitropolit*”, “*dhespopot*”, “*ekzark*” (përfaqësuesi i një patriarkane në një periferi të rëndësishme kishtarë), “*protosingjel*” (i pari mes episkopëve, ose zëvendësuesi i episkopit), “*muzikant fort i ditur*” (titull që u jepej atyre që merreshin me artin e muzikës), “*kartofilak*” (titull që i jepej një

kleriku, i cili kishte për detyrë të kujdesej për arkivin e kishës) etj.

Rëndësia e mbishkrimeve dhe shënimeve kronike për historinë e Shqipërisë

Mbishkrimet në greqisht në Shqipëri përbëjnë një burim të vyer për historinë e vendit, pasi rëndësia e tyre shtrihet në historinë e përgjithshme, lokale, politike dhe kulturore. Edhe pse këto të dhëna janë të kufizuara, disa prej tyre paraqesin një rëndësi të veçantë, për shkak se mbeten të vetmet burime për çështje historike të Shqipërisë. Përmendim këtu rëndësinë që kanë të dhënat që buronjë nga mbishkrimet dhe lidhen me zotërimin e princit shqiptar, Karl Topisë. Nga mbishkrimet kthitorike të kishës së manastirit të Shën Joan Vladimirit, pranë Elba-

dhe papa Janit, të cilët «*i vrau Ali Toska, në Kakollako, maj 14, 1772*». Sipas gojëdhënës, priftërinjtë u vranë nga Ali Toska, për shkak se kishin strehuar në kishë Ali pashë Tepelenën dhe e kishin shpëtuar, duke e nxjerrë jashtë brenda një voze. Shembulli i dytë ka të bëjë me shkatërrimin e qytetit të Vithkuqit. Shënimi kronik në greqisht, i shkruar në faqen e parë të ungjillit të kishës së Shën Mëhillit në Vithkuq, dëshmon se Vithkuqi u shkatërrua më 25 tetor 1823: “*Më 25 tetor 1823, Vithkuq. Sipas Ungjillit, zemërimi i Perëndisë vjen nga të pabesët. Në të njëjtin vit u prish vendi i famshëm i quajtur Vithkuq dhe u bë çdo gjë e shkretë...*”. Sipas një tjetër shënimi kronik në greqisht, të shkruar në hajatin jugor të së njëjtës kishë, Vithkuqi, deri më 1828, vazhdonte të ishte krejtësisht

i rrënuar, me shtëpi të prishura dhe pa njerëz: “*1828 korrik 13. Unë dhaskali, Kostak Cepi, erdha nga Belegradi (Berati) dhe e gjeta vendin të rrënuar, të shkretuar, shtëpitë të prishura dhe unë i padenji i shoh të gjitha shtëpitë (pa)... njerëz... Të mjerë e të shkretë, pësua mjerim dhe cilido që u ndal dhe e prishi fshatin të ketë mallkimin, që i bëri kishat dhe manastiret e shkretë...*”.

Një tjetër shënimi kronik në greqisht, i shkruar në kapakun e Komentarit mbi katër Ungjijtë të Theofilakti i Bullgarisë, libër dikur pronë e Manastirit të Shën Petros dhe Pavlit në Vithkuq, sot mbahet në AQSh, njofton për shkatërrimet e lagjes “Varosh” të Korçës, që ndodhën më 2 mars 1824 nga Busta beu i Plasës dhe për shkatërrimet që shkaktoi, më 10 tetor të të njëjtit vit, Sinan Beu nga frika e



Mbishkrim liturgjik i pikturuar, viti 1759. Kisha e manastirit të Shën Petros dhe Pavlit, Vithkuq.

sanit (sot ruhen në Muzeun Historik Kombëtar), rezulton se Karl Topia, princi arbëror i shek. XIV, ndërtoi kishën e manastirit «*në të 22-tin vit të zotërimit të tij dhe e mbaroi atë në të 24-tin vit të zotërimit të tij*». Nga dy mbishkrime të tjera të po së njëjtës kishë rezulton se viti i 22^{te} i zotërimit të Karl Topisë përkon me vitin 1381, nga ku del se Karl Topia u bë zotëruar i Shqipërisë së Mesme më 1359. Burimi më i hershëm arkivor e vendos fillimin e zotërimit të Karl Topisë në vitin 1362. Nën këto rrethana, mbishkrimi i kishës së Shën Joan Vladimirit mbetet burimi i vetëm historik, që sqaron një datë të rëndësishme të historisë së Shqipërisë.

Por nuk mungojnë edhe të dhëna të tjera interesante historike për periudhat e mëvonshme. Po sjellim si shembull vetëm dy prej tyre. I pari lidhet me Ali pashë Tepelenën. Në një mbishkrim në greqisht të kishës së Shën Kollit në Sopik të Pogonit, ruhet një ngjarje e vitit 1785, që lidhet me praninë e Ali pashë Tepelenës në fshatin Sopik: “*Në atë kohë ishte edhe Ali Pasha me Velin, të nisur për në Janinë me tre mijë [...] e Shtuna e Madhe, prill -19-*». Ndërsa mbishkrimi në greqisht i kishës së Fjetjes së Hyjlindëses në Sopik të Pogonit i referohet kontributit për suvatimin e kishës të tre priftërinjve, papa Kostandinit, papa Panajotit

jabanxhinjve që kishin zbritur nga lart dhe po drejtoheshin kundër tij.

Si rrjedhim, është e qartë se mbishkrimet në greqisht hedhin dritë mbi ngjarje të panjohura të traditës shumëshekullore kulturore të popullit shqiptar dhe mund të ndriçojnë pjesërisht probleme të caktuara historike, kryesisht kur mungojnë burime të tjera arkivore, duke përbërë kështu dëshmi të vetme autentike dhe të pakontestueshme.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

Andi Rembeci
Universiteti i Tiranës

Mitropolia e Elbasanit

Kremtim për Shën Gjergjin në zonën e Steblevës

Më 6 maj 2020, duke u kujdesur për masat e sigurisë dhe duke përfutur nga fakti që zona është shpallur “e gjelbër” nga Covid-19, banorët e fshatit Steblevë, Klenjë dhe fshatra të tjera përreth, festuan me gëzim të kremten e Dëshmorit të Madh, Shën Gjergj Trofeprurësit, sipas kalendarit të vjetër julian.



Liturgjinë Hyjnore e kreu kleriku i zonës, atë Heliodor Demiri. Duke qenë në periudhën pas Pashkës, besimtarët uruan njëri - tjetrin “Krishti u Ngjall! Vërtet u Ngjall!” dhe trokitën vezët e kuqe. Në vazhdim u krye një përkujtimojë për të fjeturit dhe, sipas traditës, besimtarët mbushën ujë të Vakëfi i Shën e Dielës (Qiriaqisë).



Kalendari i Liturgjive Hyjnore, MAJ 2020

3 E DIEL † E MIROPRURËSEVE

Dësh. Timoteu e Maura. Ikumeni, çudibërës

5 E Martë † Dëshmg. Irini. Efthimi i Madhitës. Oshd. i ri Efremi, çudibërës.

8 E Premte † Ap. e Ungjillor Joan Theologu. Osh. Arseni i Madh. Mili, himnolograf. *(Hahet vaj e verë)*

10 E DIEL † E TË PARALIZUARIT.

Ap. Simeon Zelloi. Dësh. Filadelfi, Alfiu.

13 E Hënë † Gjysmëpentikostia. Dëshg. Gliqeria. Dësh. Laodiki. Omol. Sergji. *(Hahet vaj, verë, peshk)*

17 E DIEL † E SAMARITANES.

Ap. Androniku e Junia nga të 70- t. Oshg. Efrosina

18 E Mërkurë † Kirili i Jerusalemit. Dësh. Eduardi në Angli. Frediani i Lukës.

21 E Enjte † Konstandini dhe Elena, mbretër. Konstandin Rusi e të bijtë.

24 E DIEL † E TË VERBRIT. Osh. Simeoni e Nikita. Dësh. Meleti, Festi, Suzana.

25 E Hënë † Gjetja III e kokës së Joan Pagëzorit. Osh. Olviani. Dësh. Celestini.

27 E Mërkurë † # Mbyllja e Pashkës. Hierod. Heladhi. Theraponi i Sardës. Joan Rusi. *(Hahet vaj, verë, peshk).*

28 E Enjte † Ngjitja e Zotit Krisht në Qiej (Analipsi). Hierod. Eftihi. Dësh. Priami

31 E DIEL TË SINODIT I EKUMENIK EKUMENIK. Petronila, bija e Ap. Petros.

Me www.orthodoxalbania.org

do të gjeni në internet Kishën Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë

Kisha jonë Orthodhokse me faqen e saj zyrtare përpigjet të përcjellë mesazhin dhe informacionin e saj edhe në internet.

Ajo i njeh vizitorët e saj me:

- besimin e krishterë orthodhoks,
- organizimin dhe veprimtarinë e strukturave institucionale,
- lajmet më të fundit,
- arsimin, edukimin dhe shërbimin social e kulturor që ofron në shoqëri,
- ndërtimin dhe restaurimin e kishave dhe manastireve,
- botimet kishtarë etj.



Teksti këtu ndërthuret me fotografi, mesazh zanor, muzikor e filmik.

Shihemi, lexohemi e dëgjohemi në moment dhe kudo në të gjithë globin me

www.orthodoxalbania.org



NGJALLJA

Organ i Kishës Orthodhokse
Autoqefale të Shqipërisë

Themelues:
Kryepiskopi Anastas

Del nën kujdesin
e Këshillit Botues

Kryeredaktor: Thoma Dhima

Adresa:

Qendra Sinodike,
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”,
Nr. 5, Tiranë

Tel: +355 4 2257261/2;

Fax: +355 4 2257263

E-mail: zyrashtypitkoash@gmail.com
orthchal@orthodoxalbania.org

Shtypur
në shtypshkronjën “Ngjallja”

Kolegji Universitar "LOGOS" - Dritë dhe fuqi jete

Kolegji Universitar "Logos" është institucion që prej 10 vjetësh ofron shërbim në fushën e edukimit të arsimit të lartë.

Kolegji Universitar "Logos" është aktiviteti i Fondacionit "Logos", i krijuar nga Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë, nën përkujdesjen e drejtpërdrejtë dhe të vazhdueshme të Fortlumturisë së Tij, Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe Gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasit, i cili e nderon këtë institucion duke kryer detyrën e Presidentit të Fondacionit. Emri dhe autoriteti i padiskutueshëm i Kryepiskopit, si një prej akademikëve më në zë, i njohur ndërkombëtarisht, në detyrën e Presidentit të këtij fondacioni, përbën një vlerë të çmuar.

Kolegji Universitar "Logos" plotëson çdo kriter për të qenë një

IAL bashkëkohor dhe për të përmbushur çdo nevojë akademike për studentët. Krahas personelit pedagogjik të përkushtuar dhe një pjese të tyre të mirënjohur në mjediset akademike, Kolegji Universitar "Logos" ofron një infrastrukturë jashtëzakonisht të mirë sa i takon procesit akademik të mësimdhënies.

Kolegji Universitar "Logos" ka aktualisht dy kampuse:

- në Tiranë, sheshi "Zogu i Zi", përballë Pallatit të Sportit "Asllan Rusi" dhe

- në Shën Vlash të Durrësit, ku ndjekin studimet studentët e programit të Teologjisë Sociale dhe Shkencave Religjioze.

Tashmë, në kampusin e Tiranës, pas punimeve rindërtuese janë krijuar hapësira të bollshme dhe bashkëkohore në shërbim të studentëve.

Salla e madhe e konferencave ka kapacitet prej 185 vendesh dhe është e pajisur me sisteme audio – vizuale moderne, e përshtatshme për aktivitete të ndryshme.

Biblioteka, e cila është ndarë në dy kampuse dhe tërësisht e rinovuar, ofron një gamë të gjerë titujsh në ndihmë të studentëve dhe është gjithnjë në proces pasurimi me literaturë të re. Biblioteka *on line*, e aksesueshme nga një numër i madh kompjuterash, u ofrohet studentëve si një alternativë praktike, e cila, në bashkëpunim edhe me universitete të tjera evropiane krijon një volum të jashtëzakonshëm mundësish për të gjithë studentët tanë.

Laboratorët e programeve të studimit janë të pajisur me teknologjinë më moderne.

Është ngritur ateljeja në mbështetje të programit në mësuesi për arsimin parashkollor.

Së shpejti do të hapet edhe kampusi i tretë në Sukth të Durrësit, ku do të kenë mundësi të studiojnë apo kryejnë praktikën studentët e programeve profesionale në Menaxhim fermë dhe Marketing të produktit bujqësor.

Në vizionin e Presidentit të Fondacionit "Logos", Kryepiskopit të Tiranës, Durrësit dhe të Gjithë Shqipërisë, Prof. Dr. Anastasit, arsimit përbën çelësin e transformimit të jetës së çdo individi. Shoqëria jonë mund të zhvillohet dhe të marrë rrugëtimin në drejtim të vlerave në saje të shkollimit të duhur.



KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"

PSE TË ZGJIDHNI KOLEGJIN UNIVERSITAR "LOGOS"!

- ✓ Programe studimi në përputhje me kërkesat e tregut;
- ✓ Disa programe studimi unike;
- ✓ Personel akademik lokal dhe ndërkombëtar;
- ✓ Mjedis të nxëni dinamik dhe ndërveprues;
- ✓ Mjedis funksionale që krijojnë mundësi për të studiuar dhe për t'u socializuar;
- ✓ Mundësi studimi në universitetet partnere ndërkombëtare;
- ✓ Tarifa të shkollimit më të mira në sektorin e arsimit të lartë privat;
- ✓ Bursa studimi deri në 100% për kategori të caktuara studentësh dhe programesh;
- ✓ Komunitet aktiv nëpërmjet veprimtarive studentore;
- ✓ Punësim profesional me partnerët tanë që gjatë studimeve;
- ✓ Mbi 95% e të diplomuarve punësohen menjëherë në profesion.



FAKULTETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA

FAKULTETI EKONOMIK

FAKULTETI I SHKENCAVE HUMANË DHE KOMUNIKIMIT GJUHËSOR

ZGJEDHJA JUAJ! ✓

+355693030277

info@kulogos.edu.al

www.kulogos.edu.al



KOLEGJI UNIVERSITAR "LOGOS"

OFRON PROGRAME STUDIMI:

● BACHELOR në:

- Financë-Kontabilitet
- Menaxhim Biznesi
- Menaxhim Turizmi
- Informatikë e Zbatuar
- Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
- Teologji Sociale dhe Studime Religjioze
- Gjuhë dhe Civilizim Grek
- Mësuesi për Arsimin Parashkollor

● PROGRAME STUDIMI ME KARAKTER PROFESIONAL ME PROFILE:

- Menaxhim i Fermës Bujqësore
- Marketing i Produktit Bujqësor

● MASTER PROFESIONAL në:

- Teknikë e Lartë në Laboratorë Mjekësorë
- Financë - Kontabilitet

Kolegji Universitar "LOGOS" është një mundësi e shkëlqyer për të përmbushur ëndrrën për studimet tuaja.

Zgjedhja juaj! ✓



E-MAIL: INFO@KULOGOS.EDU.AL / TEL: +355693030277 / WWW.KULOGOS.EDU.AL